

SEKSIONI I TRETË

ÇËSHITJA SEVDARI KUNDËR SHQIPËRISË

(Kërkesa nr. 40662/19)

VENDIM

Neni 8 – Jeta private – Shkarkim joproportional i prokurores dhe ndalim i përhershëm për të rihyrë në sistemin e drejtësisë, për shkak të një gabimi të izoluar profesional dhe mospagimit të tatimeve nga bashkëshorti i saj për një pjesë të vogël të të ardhurave të tij – Mungesë e keqbesimit ose e shkeljeve të qëllimshme nga kërkuesja

Neni 46 – Masat individuale – Rihapja e procesit të rivlerësimit, me kërkesë të kërkueses, dhe rishqyrtim i çështjes në përputhje me parashikimet e nenit 8 – Masat e përgjithshme nuk janë të nevojshme – Funkcionimi i procesit aktual të rivlerësimit në përgjithësi, pa deklaruar si të tillë problemin sistematik të respektimit të parashikimeve të Konventës

STRASBURG

13 dhjetor 2022

I FORMËS SË PRERË

13.3.2023

Ky vendim do të bëhet i formës së prerë në mbështetje të rrethanave të parashikuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund të bëhet objekt i një rishikimi redaktues.

Në çështjen Sevdari kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si një Dhomë e përbërë nga:

Pere Pastor Vilanova, *Kryetar,*

Georgios A. Serghides,

Jolien Schukking,

Darian Pavli,

Peeter Roosma,

Ioannis Ktistakis,

Andreas Zünd, *gjyqtarë*

dhe Milan Blaško, *Sekretar i Seksionit,*

Duke mbajtur në konsideratë:

kërkesën (nr. 40662/19) kundër Republikës së Shqipërisë paraqitur pranë Gjykatës, në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”) nga një shtetase shqiptare, znj. Antoneta Sevdari (“ankuesja”), më 29 korrik 2019;

vendimin për të njoftuar qeverinë shqiptare (“Qeveria”) për kërkesën;

komentet e palëve të treta të paraqitura nga Res Publica, së cilës i është dhënë leja për të ndërhyrë nga Kryetari i Seksionit (neni 36 § 2 i Konventës dhe rregulli 44 § 3 i Rregullores së Gjykatës);

Pasi diskutoi me dyer të mbyllura më datë 22 nëntor 2022,

Shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë:

HYRJE

1. Kërkesa ka të bëjë me procesin e rivlerësimit (*vetting-ut*), i cili rezultoi në shkarkimin e kërkueses nga pozicioni i prokurores. Ajo u ankua: i. se ishte shkelur e drejta e saj për respektim të jetës private, sipas nenit 8 të Konventës për shkak të shkarkimit të saj nga detyra dhe në vijim, për shkak të ndalimit të përhershëm të saj për të praktikuar ligjin si avokate; ii. në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës se procesi kishte qenë i padrejtë; dhe iii. në mbështetje të nenit 13 të Konventës për mungesën e një mjeti efektiv në lidhje me ankesat e saj në mbështetje të neneve 6 dhe 8.

FAKTET

2. Kërkesja ka lindur në vitin 1976 dhe jeton në Tiranë. Ajo u përfaqësua nga z. S. Powles, avokat i cili e ushtron profesionin e tij në Londër.

3. Qeveria u përfaqësua fillimisht nga agjenti i saj, z. A. Metani, dhe më pas nga znj. J. Mansaku, znj. E. Muçaj, znj. B. Lilo dhe z. O. Moçka, nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.

4. Faktet e çështjes mund të përmbliidhen si më poshtë.

I. SFONDI I ÇËSHTJES

5. Sfondi dhe qëllimet e reformës së sistemit të drejtësisë në Shqipëri, duke përfshirë edhe prezantimin e procesit të rivlerësimit në vitin 2016 me anë të aneksit në Kushtetutë dhe ligjit për Rivlerësimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (ligji nr. 84/2016 – “Ligji i Rivlerësimit”), si edhe mënyra se si kryhet procesi i rivlerësimit, të cilit u nënshtrohen të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë, janë përmbledhur në vendimin e Gjykatës për çështjen *Xboxhaj kundër Shqipërisë* (nr. 15227/19, §§ 4–7, 9 shkurt 2021).

6. Kërkesja ka shërbyer si prokurore pranë Gjykatës së Rrethit Durrës nga muaji tetor 2003 deri në vitin 2012. Më pas u emërua si prokurore pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë. Nga muaji dhjetor 2018 e në vijim ajo ka shërbyer si anëtare e Këshillit të Lartë të Prokurorisë (“KLP”).

II. PROCESI I RIVLERËSIMIT PËR KËRKUESEN

A. Procesi përpara Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Më 18 korrik 2018, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (“KPK”), pas një seance publike, e konfirmoi unanimisht kërkesen në postin e saj si prokurore pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë. Në përputhje me parashikimet e zbatueshme për rivlerësimin (shih paragrafët 36–42 më poshtë), KPK-ja e kishte vlerësuar kërkesen mbi bazën e tri kritereve: i. vlerësim i pasurive të saj; ii. kontroll i figurës dhe i integritetit, me qëllim konstatimin e çdo lidhjeje të mundshme me krimin e organizuar; dhe iii. vlerësim i kompetencës profesionale.

8. Në lidhje me vlerësimin e pasurive të kërkueses, mbështetur në deklarinimin, dhe provave mbi pasuritë paraqitur prej saj në procesin e rivlerësimit, KPK-ja arriti në përfundimin se deklarimi i saj për pasuritë ishte i saktë dhe i plotë, dhe se pasuritë e saj dhe të bashkëshortit të saj ishin të ligjshme. As kontrolli i figurës dhe i integritetit, i kryer mbështetur në deklaratën e paraqitur prej saj për figurën dhe integritetin, nuk përbën arsye për shqetësim. Për sa i përket vlerësimit të kompetencës profesionale të kërkueses, KPK-ja, në mbështetje të formularit të vetëvlerësimit profesional të paraqitur prej saj, dhe pasi shqyrtoi raportet si edhe denoncimet e publikut për performancën e saj, arriti në përfundimin se ajo ishte kompetente në aspektin profesional.

B. Procesi përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

1. Zhvillimi i procesit nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit

9. Më 29 gusht 2018, Komisioneri Publik apeloj vendimin e KPK-së pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (“KPA”). Ai argumentoi se hetimet e KPK-së nuk provonin se kërkesja përmbushte kërkesat e Ligjit për Rivlerësimin, si për vlerësimin e pasurive, edhe për vlerësimin e kompetencës së saj profesionale.

10. Në vijim, kërkueses iu lejua të kishte akses në dosjen e çështjes.

11. Më 17 shtator 2018, gjyqtarët e çështjes së kërkueses u përzgjedhën me short dhe në vijim, kërkuesja u vu në dijeni për përbërjen e KPA-së (një kolegi i veçantë i Gjykatës Kushtetuese). Ajo nuk kërkoi as përjashtimin dhe as nuk pretendoi për papërshtatshmërinë e ndonjërit prej gjyqtarëve të KPA-së.

12. KPA-ja i zhvilloi seancat publike në tri ditë të ndryshme (13, 19 dhe 25 shkurt 2019), përpara se shpallte vendimin më 28 shkurt 2019. Kërkueses iu dha mundësia të bënte parashtrime, të kërkonte që KPA-ja të pranonte prova të reja, apo të kërkonte dëshmitarë.

2. Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

13. Më 28 shkurt 2019, KPA-ja ndryshoi vendimin e KPK-së dhe e shkarkoi kërkuesen nga detyra i saj si prokurore. Kolegji gjykoi se ajo kishte bërë një deklaram të pamjaftueshëm të pasurive sipas kuptimit të nenit 61(3) të lexuar së bashku me nenin 33(5) të Ligjit për Rivlerësimin dhe nenin D §§ 1 dhe 3 të aneksit të Kushtetutës (shih paragrafët 42, 40 dhe 38 më poshtë), pasi ajo nuk kishte provuar ligjshmërinë e burimeve të saj financiare që ishin përdorur për të përfutur pasuritë e saj të paluajtshme, si edhe ligjshmërinë e disa prej të ardhurave të bashkëshortit të saj. Gjithashtu, pas një vlerësimi të përgjithshëm për të tria kriteret (neni 4(2) i Ligjit të Rivlerësimit, shih paragrafin 36 më poshtë), KPA-ja arriti në përfundimin se kërkuesja kishte cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë (neni 61(5) i Ligjit të Rivlerësimit, shih paragrafin 42 më poshtë).

a) Vlerësim i pasurive të kërkueses

i. Ara dhe shtëpia në Yzberisht, Tiranë

14. Ara dhe shtëpia në Yzberisht, Tiranë, ishin përfutur nga bashkëshorti – në atë kohë – i ardhshëm i kërkueses dhe të afërmit e tij nga viti 2000 deri në 2003, periudhë në të cilën kërkuesja nuk ishte ende prokurore. Për këtë arsye, KPK-ja nuk e vlerësoi këtë pronë. Megjithatë, KPA-ja, në të njëjtën linjë me Komisionerin Publik, ishte e mendimit se vlerësimi i pasurive brenda kuadrit të procesit të rivlerësimit duhej të shtrihet edhe te pasuria e përfutur përpara emërimit të kërkueses si prokurore dhe te ligjshmëria e burimeve të të ardhurave të përdorura për krijimin e tyre. Kërkuesja kishte argumentuar se pasuria e krijuar përpara emërimit të saj si prokurore nuk mund të konsiderohej se ishte krijuar me anë të akteve korruptive apo aktiviteteve të paligjshme, të cilat mund të kishin ndikim në integritetin e saj si prokurore.

15. Në deklaratën e saj të rivlerësimit, kërkuesja kishte deklaruar se ara dhe shtëpia ishin përfutur me anë të të ardhurave të bashkëshortit të saj prej 3,000,000 lekë (ALL – afërsisht 22,000 euro (EUR), në atë periudhë), të ardhura të cilat ai i kishte fituar si emigrant në Greqi nga viti 1997 deri në vitin 2000 (përpara se ajo të martohej me të), dhe me 12,000 euro, të cilat ai i kishte fituar me punën e tij si inxhinier në Arabinë Saudite në vitin 2003.

16. Në lidhje me këtë aspekt, KPA-ja gjykoi se kërkuesja kishte bërë një deklaram të pamjaftueshëm të pasurisë, sepse ajo nuk kishte mjete të mjaftueshme të ligjshme për të justifikuar arën dhe shtëpinë, për qëllimet e nenit 61(3) të Ligjit të Rivlerësimit të lexuar së bashku me nenin D § 3 të aneksit të Kushtetutës. Për qëllimet e rivlerësimit, të ligjshme mund të konsiderohen vetëm të ardhurat të cilat janë deklaruar më herët dhe për të cilat janë paguar taksat. Për pasojë, kërkuesja mund t'u referohej vetëm të ardhurave që i përmbushnin të dy këto kushte për të justifikuar përfutimin e pasurive të paluajtshme.

17. Për sa u përket të ardhurave që bashkëshorti i kërkueses i kishte fituar si emigrant në Greqi, KPA-ja gjykoi se kërkuesja nuk kishte paraqitur mjaftueshëm dokumente mbështetëse, apo prova të tjera për të treguar se të ardhurat e transferuara nga Greqia në Shqipëri në formën e remitançave kishin qenë të ligjshme. Ajo nuk kishte provuar se bashkëshorti i saj kishte qenë i punësuar në Greqi gjatë periudhës konkrete, dhe nuk kishte specifikuar shumën ekzakte të të ardhurave të fituara dhe shumën ekzakte të transferuar në Shqipëri.

18. Për sa u përket të ardhurave të fituara nga bashkëshorti i kërkueses në Arabinë Saudite në vitin 2003, KPA-ja konstatoi se kërkuesja dhe bashkëshorti i saj i kishin deklaruar këto të ardhura për herë të parë në vitin 2016, në kuadër të procesit të rivlerësimit, dhe se ata nuk kishin mundur të shpjegonin në mënyrë bindëse arsyet për mosdeklarimin e tyre në kohë. Në vijim, KPA-ja arriti në përfundimin se kërkuesja nuk kishte paraqitur prova të plota dhe të mjaftueshme për të treguar se burimi i të ardhurave të bashkëshortit të saj në këtë aspekt kishte qenë i ligjshëm. Dokumentet e paraqitura prej saj dhe deklaratat nga kompania e punësimit përmbanin “Indicie” për angazhimin profesional të personit të lidhur me kërkuesen (bashkëshorti i saj) dhe përfundimin e të ardhurave për punën e bërë. Megjithatë, ajo nuk kishte paraqitur dokumentet e nevojshme që sqaronin plotësisht mënyrën sipas së cilës ishin paguar këto të ardhura dhe që provonin se taksat për këto të ardhura ishin paguar nga kompania. Në vijim, çifti nuk kishte mundur të demonstronte se ishte objektivisht e pamundur për ta që t’i paraqisnin këto dokumente.

ii. Të ardhurat e bashkëshortit nga puna në Arabinë Saudite në vitin 2006

19. Në deklaratën e saj për rivlerësim, në vijim, kërkuesja kishte deklaruar asete financiare në shumën prej 20,000 dollarësh amerikanë (USD), të fituara nga bashkëshorti i saj në Arabinë Saudite në vitin 2006. Edhe për këtë aspekt, KPA-ja gjykoi se ajo nuk kishte deklaruar në mënyrë të mjaftueshme pasurinë, sipas interpretimit të nenit 61(3) të Ligjit të Rivlerësimit të lexuar së bashku me nenin D § 3 të aneksit të Kushtetutës, pasi ajo nuk kishte provuar se bashkëshorti i saj kishte respektuar detyrimet përkatëse për tatimet mbi të ardhurat.

20. KPA-ja gjykoi se dokumentet e paraqitura nga kërkuesja, të cilat provonin se bashkëshorti i saj kishte jetuar dhe kishte ofruar shërbime në Arabinë Saudite gjatë periudhës konkrete, ishin të besueshme, por ato nuk përbënin “provë të plotë” në mungesë të një kontrate punësimi apo prove, se transfertat përkatëse bankare ishin bërë nga Arabia Saudite në emër të kompanisë për të cilën ai kishte ofruar shërbime.

21. Në vijim, KPA-ja konstatoi se kërkuesja nuk kishte paraqitur dokumente mbështetëse për të provuar se bashkëshorti i saj kishte paguar tatimet në Shqipëri për këto të ardhura, apo prova se ai kishte paguar tatime në Arabinë Saudite, apo se objektivisht ishte e pamundur për të që të paraqiste dokumentet e nevojshme.

iii. Pasuri të tjera

22. Pronat e tjera të paluajtshme dhe të ardhurat e tjera të kërkueses dhe të bashkëshortit të saj nga burime vendëse të vlerësuara nga KPA-ja u konsideruan të ligjshme.

b) Vlerësimi i kompetencës profesionale të kërkueses

23. KPA-ja konstatoi se asnjë prej denoncimeve të bëra nga publiku, në lidhje me kompetencën profesionale të kërkueses, nuk paraqiste mungesë të kompetencës profesionale prej saj.

24. Në lidhje me vlerësimin e një sërë çështjesh të trajtuara nga kërkuesja dhe të përzgjedhura për shqyrtim, në kuadër të rivlerësimit, KPA-ja konstatoi se në njërin prej këtyre çështjeve, e cila kishte të bënte me akuzat kundër një zyrtari publik për mosdeklarim të rregullt të pasurisë së tij, kërkuesja nuk kishte respektuar afatin për dorëzimin e një apelimi ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë për rrëzim të akuzave. Kërkesa e saj e mëpasshme për të marrë leje për apelim jashtë afatit për shkak të vështirësive familjare ishte rrëzuar. Në lidhje me këtë aspekt, KPA-ja arriti në përfundimin se edhe nëse rezultatet e hetimit konfirmonin se kërkuesja kishte demonstruar mungesë njohurish të praktikës gjyqësore, në lidhje me një koncept specifik ligjor dhe mungesë efikasiteti në menaxhimin e situatave komplekse në ushtrimin e detyrave të saj, çështja konkrete ishte e izoluar, dhe për këtë arsye, e pamjaftueshme në vetvete për të gjykuar se ajo ishte e paaftë profesionalisht. Megjithatë, KPA-ja gjykoi se fakti se çështja kishte të bënte me deklarimin e pasurisë së një zyrtari publik, edhe pse një rast i izoluar, kishte ndikim në besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Si prokurore e

specializuar në veprat që kanë lidhje me tatimet, një gjë e tillë cenonte besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, nëse vetë anëtarët e familjes së saj nuk respektonin ligjet për tatimet.

c) Vlerësimi i përgjithshëm

25. Për këtë arsye, KPA-ja arriti në përfundimin, se mbështetur në një vlerësim të përgjithshëm të tri kriterëve të vlerësimit, kërkuesja kishte cenuar edhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, për qëllimet e nenit 61(5) të Ligjit të Rivlerësimit.

d) Opinion mospajtuës

26. Njëri prej anëtarëve të trupit gjykues, I.R., paraqiti një opinion mospajtuës, në mbështetje të pozicionit se kërkuesja nuk duhej të shkarkohej nga detyra si prokurorë. I.R. mbështeti mendimin se kërkuesja nuk kishte bërë deklaram të pamjaftueshëm të pasurisë sipas neneve 61(3) dhe 33 të Ligjit të Rivlerësimit. Ajo kishte provuar burimet e ligjshme të pasurive të saj deri në atë moment, ashtu siç kishte provuar mjaftueshëm ekzistencën e të ardhurave të bashkëshortit të saj dhe faktin se pasuria vinte nga veprimtari fitimprurëse të ligjshme (dhe jokriminale). Në opinionin mospajtuës të gjyqtarës, fakti se nuk provohet shlyerja e tatimeve për këto të ardhura nuk duhet të çojë gjithmonë në përfundimin se ka pasur burime të pamjaftueshme të ligjshme për të justifikuar pasurinë e personit dhe, për pasojë, deklarimi i pamjaftueshëm i pasurisë të çojë shkarkimin nga detyra sipas nenit 61(3) të Ligjit për Rivlerësimin. Në të tilla rrethana, neni 61(1) i Ligjit të Rivlerësimit duhet të zbatohet, si i tillë, vetëm në rastin kur pasuria e deklaruar e personit të rivlerësuar do të ishte më e madhe se sa dyfishi i vlerës së pasurisë së përfutur, së bashku me të ardhurat e tatueshme, duke përbërë kështu shkak për shkarkim nga detyra. Megjithatë, ky nuk ishte rasti për kërkuesen; të ardhurat e kundërshtuara përbënin 9.5% të totalit të të ardhurave. Në vijim, I.R. shprehu opinionin se shkarkimi i kërkueses për cenim të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë ishte joproporcional, pasi ajo kishte ndjekur penalisht në mënyrë të suksesshme shumë çështje të rëndësishme publike financiare.

c) Opinioni i Vëzhguesit Ndërkombëtar

27. Edhe Vëzhguesi Ndërkombëtar i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (“ONM”) – një organ ndërkombëtar i udhëhequr nga Komisioni Evropian, i krijuar në mbështetje të nenit B të aneksit të Kushtetutës, për të mbështetur, monitoruar dhe mbikëqyrur procesin e rivlerësimit – dha një opinion mospajtuës, më 25 prill 2019. Ai u shpreh se ishte joproporcionale që kërkuesja të sanksionohej me shkarkim nga detyra. Ai iu referua konstatimit të KPA-së se ajo kishte respektuar detyrimin për deklaram të pasurisë së saj dhe burimeve të lidhura të të ardhurave. Megjithatë, KPA-ja kishte gjykuar se (në kundërshtim me konstatimet e KPK-së) se ajo nuk kishte paraqitur justifikim të mjaftueshëm për pasuritë e saj, që do të thotë se ajo nuk kishte paraqitur mjaftueshëm dokumente për të provuar ligjshmërinë e burimeve të pretenduara të të ardhurave, veçanërisht prova për shlyerjen e tatimeve për ato të ardhura.

28. Vëzhguesi Ndërkombëtar shprehu mendimin se interpretimi i gjerë i KPA-së “i deklarimit të pamjaftueshëm të të ardhurave” në nenin 61(3) të Ligjit të Rivlerësimit, si shkak për shkarkim nga detyra binte në kundërshtim me nenin D §§ 4 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, dhe jepte rezultate joproporcionale. Ai argumentoi veçanërisht se konstatimi për “deklaram të pamjaftueshëm”, në mbështetje të nenit 61(3) të Ligjit të Rivlerësimit mund të përmbushej vetëm nëse personi i rivlerësuar kishte bërë një deklaratë false, veçanërisht, nëse kishte prova se ai ose ajo nuk e zotëronte burimin e pretenduar të të ardhurave (gjë të cilën KPA-ja nuk e kishte konstatuar në çështjen e kërkueses). Mosjustifikimi i pasurive të deklaruara mund të sanksionohej sipas nenit 61(1) të Ligjit të Rivlerësimit, në rast se nuk përmbusheshin parashikimet në këtë nen (që do të thotë, nëse pasuria e pajustificuar ishte më shumë se sa gjysma e shumës së pasurisë në total), çka nuk ishte rasti i kërkueses. Nëse mosjustifikimi i pasurisë së deklaruar sanksionohej si deklaratë e pamjaftueshme,

neni 61(1) i Ligjit të Rivlerësimit nuk do të ishte i vlefshëm për rastin konkret dhe parashikimi i pragut prej “dyfish” nuk do të ishte i zbatueshëm.

29. Për sa ka të bëjë me profesionalizmin, Vëzhguesi Ndërkombëtar ishte i mendimit se mosdorëzimit të një apelimi për një çështje brenda afatit nuk i duhej dhënë ndonjë peshë e rëndësishme. Ai theksoi se apelimi do të duhej të dorëzohej në përputhje me udhëzimet e përgjithshme sipas së cilave prokuroria duhej të vepronte në këtë mënyrë sa herë që gjykata merrte një vendim në kundërshtim me kërkesat e prokurorisë; apelimi konkret nuk kishte pasur ndonjë perspektivë të arsyeshme për sukses, kështu që kjo vonesë kishte qenë thjesht e natyrës formale. Aspektet e dobëta në tërësi nuk ishin të një rëndësie të tillë sa për të justifikuar përfundimin se kërkesja kishte cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë për qëllime të nenit 61(5) të Ligjit të Rivlerësimit.

III. ZHVILLIME TË MËTEJSHME

A. Jeta profesionale e kërkueses pas vendimit të KPA-së

30. Më 19 mars 2019, KLP, duke marrë në konsideratë shkarkimin e kërkueses nga pozicioni i prokurores, e shkarkoi atë si anëtare të KLP-së.

31. Kërkesja, e cila kishte marrë një licencë për të praktikuar ligjin si avokate nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë më 6 maj 2016, u regjistrua në regjistrin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë si avokate më 7 mars 2019 për të ushtruar në mënyrë aktive profesionin, dhe në vijim nisi të praktikonte ligjin si avokate.

B. Procesi në lidhje me Gjyqtarët L.D. dhe A.H.

32. Më 4 dhjetor 2019, KPA-ja rrëzoi kërkesën e paraqitur nga kërkesja pas përfundimit të procesit të rivlerësimit ndaj saj (më 23 maj 2019) për nisjen e një procedure disiplinore ndaj dy anëtarëve të KPA-së, L.D. dhe A.H., dhe për ndërprerjen e mandatit të tyre në mbështetje të parashikimeve kushtetuese dhe statutore për heqjen nga detyra të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, tek të cilët ishte referuar kërkesja.

33. Më 20 nëntor 2019, ONM, që sipas nenit 17 të Ligjit të Rivlerësimit ishte organi kompetent për shqyrtimin e kërkesave për procese disiplinore nga publiku, e bëri me dijeni kërkesën se pavarësisht pretendimeve të ngritura prej saj ndaj Gjyqtarëve L.D. dhe A.H., nuk mund të adresohet asnjë prej shkaqeve të parashikuar në nenin 16 të Ligjit të Rivlerësimit, sipas së cilit anëtarët e ONM mund të ndërmerrenin procese disiplinore.

34. Më 24 korrik 2020, pas nisjes së procesit penal ndaj Gjyqtarit L.D., proces që kishte nisur në mbështetje të një ankese penale të paraqitur nga Z.B. Cani (kërkuës në kërkesën nr. 37474/20 përpara kësaj Gjykate), KPA-ja vendosi ta pezullojë L.D. nga detyra. Më pas, L.D. u dënua për falsifikim dokumentesh. Rezultoi se ai kishte dorëzuar informacione false në aplikimin e tij për pozicionin e gjyqtarit në KPA, pasi nuk kishte deklaruar se ishte shkarkuar nga detyra si gjyqtar në vitin 1997 (shih, për më tepër informacione për këtë çështje, vendimin *Besnik Cani kundër Shqipërisë*, nr. 37474/20, §§ 8–31, 4 tetor 2022 (jo i formës së prerë)).

35. Më 28 tetor 2022, Gjykata Kushtetuese prishi, mbi shkaqet për gjykim të drejtë, vendimin e Gjykatës së Lartë duke konfirmuar dënimin penal ndaj L.D., dhe urdhëroi ridëgjimin e çështjes nga Gjykata e Lartë.

KUADRI LIGJOR DHE PRAKTIKA LIGJORE PËRKATËSE

I. MATERIALET PËRKATËSE VENDËSE

A. Kuadri i përgjithshëm dhe funksionimi i procesit të rivlerësimit/*vetting*-ut në Shqipëri

36. Rivlerësimi tranzitor i gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri udhëhiqet nga neni 179/b i Kushtetutës, aneksi i Kushtetutës dhe Ligji për Rivlerësimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (ligji nr. 84/2016 – “Ligji i Rivlerësimit/*Vetting*-ut”), i cili hyri në fuqi më 8 tetor 2016. Neni 179/b i

Kushtetutës parashikon rivlerësimin e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë, që bëhet një herë, me qëllim garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit gjyqësor dhe rikthimit të besimit të publikut në institucionet e atij sistemi. Rivlerësimi bëhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (“KPK”) në shkallë të parë, dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit (“KPA”), si një kolegji i veçantë pranë Gjykatës Kushtetuese, në apel. Rivlerësimi konsiston në vlerësimin e pasurisë, në kontrollin e figurës dhe integritetit, dhe në vlerësimin e kompetencës profesionale (shih nenin Ç § 1 të Aneksit të Kushtetutës, dhe nenin 4(1) të Ligjit të Rivlerëimit). Vendimi për vlerësimin mbështetet vetëm në njërin ose në disa prej këtyre komponentëve, ose në një vlerësim të përgjithshëm të të tre komponentëve dhe në një vlerësim të përgjithshëm të procesit (neni 4(2) i Ligjit të Rivlerëimit).

37. Kuadri dhe praktika ligjore përkatëse, në lidhje me procesin e rivlerëimit/*vetting*-ut të prezantuar në Shqipëri në vitin 2016, përmbledhen në vendimin për çështjen *Xboxhaj* (cituar më sipër, §§ 93–226). Parashikimet dhe praktika referuar çështjes konkrete janë, si më poshtë.

B. Parashikimet për vlerësimin e pasurive

38. Neni D i Aneksit të Kushtetutës, i cili rregullon vlerësimin e pasurive, parashikon si më poshtë:

Neni D – Vlerësimi i pasurive

“1. Subjektet e rivlerëimit i nënshtrohen deklaramit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

2. Subjekti i rivlerëimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave kontrollon deklaratën e pasurisë dhe i dorëzon Komisionit një raport për ligjshmërinë e pasurive, për saktësinë dhe plotësinë e deklaramit, sipas ligjit.

3. Subjekti i rivlerëimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme, për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj.

4. Nëse subjekti i rivlerëimit ka një pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ai prezumohet fajtor për shkeljen disiplinore, përveçse kur ai paraqet prova që vërtetojnë të kundërtën.

5. Nëse subjekti i rivlerëimit nuk e dorëzon deklaratën e pasurisë në kohë sipas ligjit, ai shkarkohet nga detyra. Nëse subjekti i rivlerëimit përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.”

39. Neni 3 i Ligjit të Rivlerëimit/*Vetting*-ut përmban përkufizimin e mëposhtëm për termin “persona të lidhur”:

“13. “Person i lidhur” është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerëimit, komisionerin, gjyqtarin dhe komisionerin publik, i përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person tjetër të përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin e rivlerëimit, komisionerët, gjyqtarët dhe komisionerët publikë për periudhën e rivlerëimit...”

40. Pjesa përkatëse për procedurën e rivlerëimit, në nenin 33 të ligjit të *vetting*-ut, parashikon si më poshtë:

“5. Në përfundimin të kontrollit, Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, sipas rastit, konstaton se:

a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe që nuk gjendet në situatë konflikti interesi;

b) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;

c) është kryer fshehje e pasurisë;

ç) është kryer deklarim i rremë;

d) subjekti [personi i rivlerësuar] gjendet në situatën e konfliktit të interesit.”.

C. Sanksionet disiplinore

41. Neni E § 1 i Aneksit të Kushtetutës, dhe nenet 58 dhe 66 të Ligjit të Rivlerësimit parashikojnë, se në përfundim të procesit, organet e *vetting*-ut mund ta konfirmojnë në detyrë personin e rivlerësuar ose të vendosin njërin prej sanksioneve të mëposhtme disiplinore: pezullim nga detyra për një vit shoqëruar me detyrimin për të ndjekur një program trajnimi të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, ose shkarkim nga detyra.

42. Sipas nenit 61 të Ligjit të Rivlerësimit, shkarkimi nga detyra mund të urdhërohet nëse rezulton, se:

“1. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të.

2. Ka probleme serioze gjatë kontrollit të figurës, sepse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar që bën të pamundur vazhdimin e detyrës.

3. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 39 dhe 33 të këtij ligji.

4. Kur rezulton se subjekti i rivlerësimit është i papërshtatshëm nga aspekti profesional, për sa ka të bëjë me vlerësimin e kompetencës profesionale.

5. Në rast se nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4(2) ... rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.”.

D. Parashikimet dhe praktika në lidhje me kundërshtimet për përbërjen e KPA-së

43. Në lidhje me garancitë për paanshmëri, pjesët përkatëse të nenit 27 të Ligjit të Rivlerësimit parashikojnë, si më poshtë:

“1. Anëtari i institucioneve të rivlerësimit deklaron dhe shmang çdo situatë konflikti interesi, në respektim të ligjit “Mbi parandalimin e konfliktit të interesit”. Çdo vendim i marrë në një situatë konflikti interesi, përveç pasojave ligjore në procesin e vendimmarrjes, përbën shkelje disiplinore, sipas këtij ligji.

2. Në rast se anëtari i institucioneve të rivlerësimit nuk mund të shqyrtojë një çështje që i është caktuar për shkaqet e përmendura në nenin 30 të Kodit të Procedurave Administrative ose të ligjit “Mbi parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, ai njofton me shkrim menjëherë trupin gjykues. Përrjashtimi i komisionerit, gjyqtarit ose Komisionerit Publik nga shqyrtimi i çështjes vendoset nga një tjetër trup gjykues që caktohet me short.

...”.

44. Në mbështetje të praktikës së Gjykatës Kushtetuese në lidhje me ankesat për mosrespektim të kriterëve statutorë të përzgjedhshmërisë nga ana e anëtarëve të organeve të *vetting*-ut, më 20 prill 2020, kjo gjykatë rrëzoi si të papranueshme ankesën e paraqitur nga z. B. Cani (shih paragrafin 34 më sipër), i cili kërkonte që vendimi i Parlamentit për emërimin e L.D. në KPA të deklarohet jokushtetues.

45. Për sa ka të bëjë me ankesën e z. Cani bërë në mbështetje të nenit 131 § 1 (f) të Kushtetutës, me argumentin se emërimi i L.D. në KPA në shkelje me ligjin vendës kishte shkelur të drejtën e tij

individuale për një “gjykatë të krijuar nga ligji” gjatë procesit të rivlerësimit, Gjykata Kushtetuese e rrëzoi këtë ankesë, duke arsyetuar si më poshtë:

“20. Në çështjen konkrete, Kolegji [i Gjykatës Kushtetuese] vëren se ankuesi pretendon të jetë cenuar e drejta e tij për një gjykim të drejtë për shkak të një veprimi të ndërmarrë nga një autoritet publik përpara përfundimit të procedurave në KPA, dhe, për pasojë nuk ngre asnjë pretendim kundër rezultatit përfundimtar të procesit [të *vetting*-ut]. Ai ka kundërshtuar... emërimin [e L.D. në KPA] dhe [ka kërkuar] pavlefshmërinë e pjesshme të vendimit të Parlamentit që caktonte L.D. si anëtar të KPA-së.

21. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se e drejta për një gjykim të drejtë, duke përfshirë ankesat në lidhje me gjykatën e krijuar me ligj, garantohet gjatë një procesi ligjor ose gjyqësor në funksion të rezultatit përfundimtar, i cili sjell pasoja konkrete dhe të drejtpërdrejta për ankuesit si mbajtës i të drejtave kushtetuese procedurale dhe thelbësore. Kolegji vlerëson se edhe në procesin e rivlerësimit kalimtar, në procesin gjyqësor të kryer nga Kolegji i Posaçëm i Apelit duhet të garantohen të drejtat procedurale të subjekteve të rivlerësuar, në përputhje me kompetencat që përcaktohen nga Kushtetuta dhe ligji.

...

23. Për më tepër, Kolegji vëren se juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e ankimit individual kushtetues të kërkuarit, që lidhet me kryerjen e rivlerësimit kalimtar të tij, për shkak të detyrës së prokurorit, është i kufizuar nga juridiksioni që vetë Kushtetuta, në aneksin e saj, u ka dhënë organeve të rivlerësimit. Kështu, neni 179/b, paragrafi 2, i Kushtetutës parashikon se procesi i rivlerësimit, që realizohet nga KPK-ja dhe KPA-ja, do të kryhet mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt ligjor, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të vlerësimit.

...

24. Kolegji thekson se të drejtat procedurale kushtetuese të subjekteve të rivlerësimit [...], duke përfshirë të drejtën për një “gjykatë të krijuar me ligj”, garantohen nga Kushtetuta, me anë të një procesi gjyqësor të kryer nga KPA-ja, dhe më pas, me anë të mundësisë për të ushtruar të drejtën ankim në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut. Duke pasur parasysh pushtetin e KPA-së për të gjykuar apelimet kundër vendimeve të KPK-së, gjykata vlerëson se ky proces [apelimi] përfshin shqyrtimin e pajtueshmërisë së procedurave me Kushtetutën...”

E. Parashikimet për rishikimin e vendimeve të formës së prerë

46. Në mbështetje të nenit 4(6) të Ligjit të Rivlerësimit, lexuar së bashku me nenin 1(2) të Ligjit për Gjykatat Administrative (ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative”), organet e rivlerësimit, në rrethana të caktuara, mund të zbatojnë parashikimet e Kodit të Procedurës Civile. Neni 494 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se një palë mund të kërkojë rishikimin e një vendimi i cili është bërë i formës së prerë në rrethana të caktuara, më konkretisht, kur:

“a) zbulohen rrethana të reja apo prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të dihen nga pala gjatë shqyrtimit të saj;

b) vërtetohet se thëniet e dëshmitarëve apo mendimet e ekspertëve, mbi të cilat është bazuar vendimi, kanë qenë të rreme;

c) palët ose përfaqësuesit e tyre apo ndonjë anëtar i trupit gjykues, që ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes, kanë kryer vepra 214 të dënueshme penalisht, të cilat kanë ndikuar në dhënien e vendimit;

ç) vërtetohet se vendimi i dhënë është bazuar në dokumente të falsifikuara;

d) vendimi është bazuar në një vendim të gjykatës ose të një institucioni tjetër që më pas është prishur;

dh) vendimi është në kundërshtim të hapur me një vendim tjetër të formës së prerë të dhënë midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak.

e) kur Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të Konventës Evropiane, “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”, dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.”.

F. Parashikime në lidhje me statusin e prokurorëve

47. Sipas nenit 32 të ligjit të mëparshëm për Prokurorinë, i datës 12 shkurt 2001 (ligji nr. 8737/2001, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë”), të ndryshuar, shkeljet disiplinore përfshinin, *inter alia*, veprime që diskreditonin seriozisht funksionin e prokurorit, ose veprime, që sipas ligjit, nuk ishin të pajtueshme me të. Sipas nenit 33 të atij ligji, shkelje të tilla ishin të dënueshme me anë të një vërejtjeje, paralajmërimi për shkarkim nga detyra, transferim në një pozicion më të ulët ose shkarkim nga detyra.

48. Gjykata Kushtetuese deklaroi se aktet serioze që diskreditonin funksionin zyrtar përfshinin sjelljen e papërshtatshme dhe të padenjë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare ose jashtë atyre detyrave (vendimi nr. 75/2002).

49. Ligji “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i datës 6 tetor 2016 (ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”) përcakton statusin e “magjistratëve”, më konkretisht të gjyqtarëve dhe prokurorëve (neni 2 (gj)). Pjesa përkatëse e nenit 3 të këtij ligji, parashikon, si më poshtë për vlerat themelore:

“5. Sjellja e magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij garanton ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, profesioni ligjor dhe palëve në proces. Magjistrati ushtron funksionet me drejtësi, në mënyrë korrekte, në kohë të arsyeshme, të ndërgjegjshme, të kujdesshme, të zellshme dhe sistematike, me objektivitet, vetëpërmbytje dhe maturi.”.

G. Parashikimet në lidhje me ushtrimin e profesionit të avokatëve

50. Sipas nenit 13(1) të Ligjit për Profesionin e Avokatit (ligji nr. 55/2018, i datës 23 korrik 2018, për profesionin e avokatit), një person është i kualifikuar për të vepruar si avokat, kur ai ose ajo ka fituar titullin “avokat” dhe është pranuar si avokat, sipas fuqisë së një certifikate (licence) të lëshuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë (më konkretisht “Shoqata e Avokatëve”). Neni 13(2) liston një sërë kërkesash të përgjithshme të cilat duhet të përmbushen në mënyrë që një person të pranohet si avokat, midis të cilave, më afër qëllimeve të kësaj çështjeje, është kërkesa që “një person të mos jetë shkarkuar nga ushtrimi i detyrës ose funksionit publik, për arsye të integritetit etik, me vendim të organit kompetent, që ka marrë formë të prerë, me përjashtim të rasteve kur masa disiplinore është shuar sipas legjislacionit të posaçëm”.

II. MATERIALET PËRKATËSE NDËRKOMBËTARE

51. Pjesët përkatëse të Udhëzimeve Evropiane për Etikën dhe Sjelljen për Prokurorët Publikë (“Udhëzimet e Budapestit”), të miratuara nga Konferenca e Prokurorëve të Përgjithshëm të Evropës, Këshilli i Evropës, e datës 31 maj 2005, parashikon:

IV. Sjellja private

“a) Prokurorët publikë nuk duhet të kompromentojnë integritetin, drejtësinë dhe paanshmërinë aktuale ose të perceptuar në mënyrë të arsyeshme, të shërbimit të prokurorisë publike me anë të aktiviteteve në jetën e tyre private.

b) Prokurorët publikë respektojnë dhe i binden ligjit gjatë gjithë kohës.

c) Prokurorët publikë duhet të sillen në mënyrë të tillë që të përforcojnë dhe të ruajnë besimin e publikut në profesionin e tyre.

...”.

52. Pjesët përkatëse të opinionit nr. 13 (2018) për pavarësinë, llogaridhënien dhe etikën e prokurorëve, lëshuar nga Këshilli Konsultativ i Prokurorëve të Evropës, të Këshillit Evropian (CCPE) parashikojnë:

“22. Sjellja e prokurorëve, ashtu si edhe e gjyqtarëve, nuk mund të lihet vetëm në diskrecionin e tyre, si brenda edhe jashtë detyrës së tyre. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur vlerësohen veprimtaritë e prokurorëve dhe në proceset disiplinore ndaj tyre.

...”

51. Respektimi i shtetit të së drejtës kërkon standardet më të larta etike dhe profesionale në sjellje të prokurorëve, edhe të gjyqtarëve, si gjatë detyrës edhe jashtë saj, çka mundëson besimin e shoqërisë të drejtësia. Prokurorët veprojnë në emër të njerëzve dhe në interes të publikut. Për këtë arsye, ata duhet të ruajnë gjithmonë integritetin personal dhe të veprojnë në përputhje me ligjin në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe objektive, duke respektuar dhe ruajtur të drejtat dhe liritë themelore, duke përfshirë prezumimin e pafajësisë, të drejtën për gjykim të drejtë, dhe parimet e barazisë së armëve, ndarjes së pushteteve, dhe forcën detyruese të vendimeve të gjykatës. Ata kanë detyrën të jenë të pavarur nga ndikimet politike, apo ndikime të tjera.”

LIGJI

I. KUNDËRSHTIMI PARAPRAK I QEVERISË

53. Qeveria parashtrori se kërkesja kishte shpërdorur të drejtën e saj për të paraqitur një kërkesë pasi ankesa e saj se ajo nuk e kishte pasur të mundur të ushtronte profesionin e saj pas përfundimit të procesit të rivlerësimit mbështetëj në fakte të pavërteta. Veçanërisht, Qeveria argumentoi se ndryshe nga parashtrimet në kërkesën e saj pranë Gjykatës, aktualisht, ajo e ushtronte profesionin si avokate.

54. Kërkesja e kundërshtoi këtë këndvështrim. Ajo pretendoi se kishte parashtruar në kërkesën e saj, dhe kishte mbështetur qëndrimin se, si rezultat i shkarkimit të saj në procesin e rivlerësimit ajo ndalohej në mënyrë të përhershme të praktikonte ligjin si avokate, në mbështetje të nenit 13(2) të Ligjit për Avokatët (shih paragrafin më sipër). Për këtë arsye, ajo rrezikonte t'i hiqej e drejta e avokatisë në çdo moment pa pasur mundësinë që të regjistrohej përsëri.

55. Gjykata përsërit se sipas nenit 35 § 3 (a) të Konventës, një kërkesë mund të kundërshtohet si shpërdorim i së drejtës për kërkesë individuale, nëse, midis të tjerash, ajo mbështetet me dashje në fakte të pavërteta (shih *Akdivar dhe të Tjerët kundër Turqisë*, 16 shtator 1996, §§ 53–54, *Raportet e Gjyqimeve dhe Vendimeve* 1996-IV, dhe *Varbanov kundër Bullgarisë*, nr. 31365/96, § 36, GJEDNJ 2000-X). Parashtrimi i informacioneve të paplota, dhe për pasojë mashtruese, mund të shkaktojë shpërdorim të së drejtës për të bërë një kërkesë, veçanërisht nëse informacionet kanë të bëjnë me vetë thelbin e çështjes dhe nëse nuk ofrohen shpjegime të mjaftueshme për mosdeklarimin e atyre informacioneve (shih *Gross kundër Zvicrës* [DHM], nr. 67810/10, § 28, GJEDNJ 2014). E njëjta gjë zbatohet nëse kanë ndodhur zhvillime të reja dhe të rëndësishme gjatë procesit përpara Gjykatës, dhe në rastin kur, pavarësisht se kjo gjë kërkohet shprehimisht në rregullin 47 § 7 (më herët rregulli 47 § 6) i Rregullores së Gjykatës, kërkuesi nuk deklaroi informacionet e kërkuara në Gjykatë, në këtë mënyrë duke e penguar atë të gjykojë për çështjen në dijeni të plotë të fakteve (shih *Mirolubovs dhe të Tjerët kundër Letonisë*, nr. 798/05, § 63, 15 shtator 2009, dhe *Centro Europa 7 S.r.l. dhe Di Stefano kundër Italisë* [DHM], nr. 38433/09, § 97, GJEDNJ 2012). Megjithatë, edhe në këto raste, qëllimi i kërkuarit për të mashtruar Gjykatën duhet të provohet me siguri të mjaftueshme (shih *Centro Europa 7 S.r.l. dhe Di Stefano*, § 97, dhe *Gross*, § 28, të dy cituar më sipër).

56. Pas shqyrtimit të dosjes së çështjes dhe të parashtrimeve të palëve në respektim të parimeve mësipërme, Gjykata shprehet se parashtrimet e kërkuarës mund të kishin qenë më të qarta për sa ka të bëjë me faktin se në praktikë, ajo kishte filluar të punonte si avokate pas shkarkimit të saj si prokurore. Megjithatë, duke iu referuar shpjegimeve të dhëna prej saj, Gjykata nuk e gjykon si të

provuar faktin se ajo nuk e dha atë informacion, i cili nuk përbën esencën e çështjes për shkarkimin e saj në procesin e rivlerësimit, si përpjekje të qëllimshme për të mashtruar Gjykatën. Për këtë arsye, në lidhje me këtë aspekt, kundërshtimi i Qeverisë duhet të rrëzohet.

II. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 8 TË KONVENTËS

57. Kërkuesja u ankua se shkarkimi i saj nga detyra si prokurore dhe më pas, ndalimi i përhershëm për të praktikuar ligjin si avokate kishin shkelur të drejtën për respektimin e jetës së saj private, sipas parashikimit të nenit 8 të Konventës, i cili parashikon, si më poshtë:

“1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private...

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.”

A. Pranueshmëria

1. Ankesa në lidhje me shkarkimin e kërkueses nga detyra

58. Duke iu referuar kriterëve të përcaktuara në vendimin e Gjykatës në çështjen *Denisov kundër Ukrainës* ([DHM], nr. 76639/11, §§ 123 dhe 125, 25 Shtator 2018), Qeveria parashittoi se neni 8 nuk ishte i zbatueshëm në rastin e ankesës së kërkueses për shkarkimin e saj. Ajo nuk kishte provuar se shkarkimi i saj nga detyra publike si prokurore kishte ndikuar në jetën e saj private në një masë mjaftueshëm serioze përderisa ajo tashmë po praktikonte ligjin si avokate.

59. Kërkuesja argumentoi se shkarkimi i saj si prokurore kishte ndikuar në mënyrë të konsiderueshme jetën e saj private dhe se, duke mbajtur në konsideratë kriteret e përcaktuara në çështjen *Denisov* (cituar më sipër, §§ 107 dhe 114), neni 8 do të ishte i zbatueshëm. Humbja e punës dhe e pagës kishte shkaktuar përkeqësimin e mirëqenies materiale të saj dhe të familjes së saj. Më pas, ajo kishte humbur mundësitë profesionale; reputacioni i saj ishte dëmtuar dhe ajo ishte stigmatizuar në sytë e shoqërisë për shkak të largimit të saj nga gjyqësori.

60. Gjykata u referohet kriterëve të përcaktuara në praktikën gjyqësore për mosmarrëveshjet për punësimin që përfshihen në fushën e veprimtimit të jetës private sipas kuptimit të nenit 8, duke përfshirë nevojën e një kërkuesi të tregojë se është arritur pragu i gjendjes serioze të situatës në rastin kur, sipas nenit 8, lind një problematikë, për shkak të pasojave të shkaktuara nga masa e kundërshtuar për punësimin ndaj jetës së tij/saj private (“qasja me bazë pasojat”, shih *Denisov*, cituar më sipër, §§ 115–17). Në vijim, Gjykata u referohet përfundimeve të saj në çështjen *Xboxhaj* (cituar më sipër), ku konstatoi se neni 8 ishte i zbatueshëm për shkarkimin nga pozicioni në gjyqësor i kërkuesit, në mbështetje të Ligjit të Rivlerësimit (ibid., §§ 362–64).

61. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se kërkuesja ishte shkarkuar nga detyra si prokurore karriere në mbështetje të Ligjit të Rivlerësimit, duke humbur me efekt të menjëhershëm funksionin e saj në sistemin e drejtësisë dhe pagën e saj. Pa dyshim që një gjë e tillë kishte pasojë serioze për “rrethin e saj të brendshëm”, që do të thotë, për mirëqenien e saj dhe të familjarëve të saj. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, fakti se në vijim, ajo pati mundësi të bënte një profesion tjetër ligjor dhe të praktikonte ligjin si avokate nuk vë në pikëpyetje këtë konstatim. Për më tepër, organet e rivlerësimit shqyrtuan kompetencën e saj profesionale dhe arritën në përfundimin se ajo kishte cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë (shih paragrafin 13 më sipër). Shkarkimi i saj, veçanërisht për atë shkak, dhe mbështetur në Ligjin e Rivlerësimit, që ishte miratuar për të luftuar korrupsionin, nënkuptonte se në sytë e shoqërisë, ajo ishte stigmatizuar si e padenjë për të kryer funksionin e prokurores.

62. Gjykata arrin në përfundimin se shkarkimi i saj nga detyra në prokurori kishte ndikim në jetën e saj private në një shkallë të konsiderueshme. Për këtë arsye, neni 8 është i zbatueshëm dhe kundërshtimi i Qeverisë në këtë aspekt duhet të rrëzohet.

63. Gjykata vëren se kjo pjesë e kërkesës nuk është as e pambështetur qartazi në fakte dhe as e papranueshme për ndonjë nga shkaqet e tjera të listuara në nenin 35 të Konventës. Për këtë arsye, ajo duhet të deklarohet e pranueshme.

2. *Ankesa në lidhje me ndalimin e përbërshëm të kërkuësës për të praktikuar ligjin si avokate*

64. Qeveria parashtroi se ankesa e kërkuësës se ajo nuk kishte mundësi të ushtronte profesionin e saj pas përfundimit të procesit të rivlerësimit ishte qartazi i pambështetur në fakte. Aktualisht, ajo po praktikonte ligjin si avokate në Tiranë, pasi Dhoma Kombëtare e Avokatisë e kishte regjistruar me kërkesën e saj (shih paragrafin 31 më sipër). As Ligji i Rivlerësimit dhe as ndonjë nga vendimet e marra nga organet e rivlerësimit nuk e kishin ndaluar atë të bënte këtë gjë. Qeveria konfirmoi se neni 13(2) i Ligjit për Avokatinë (shih paragrafin 50 më sipër) parashikonte se personat e shkarkuar me anë të një vendimi të formës së prerë nga një detyrë publike për probleme të lidhura me etikën në marrëdhëniet e punësimit nuk mund të praktikonin ligjin si avokatë. Megjithatë, kërkuësja nuk ishte shkarkuar për kryerjen e ndonjë krimi dhe as për arsye etike për qëllimet e atij parashikimi.

65. Kërkuësja parashtroi se ajo kishte një licencë nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë që prej datës 6 maj 2016, të cilën nuk e kishte fshehur, dhe se kishte filluar të praktikonte ligjin si avokate pas shkarkimit të saj si prokurore. Megjithatë, sipas nenit 13(2) të Ligjit të Avokatisë, ajo rrezikonte t'i hiqej e drejta për kryerjen e profesionit të avokatisë në çdo moment si rezultat i shkarkimit të saj në procesin e rivlerësimit pa mundësi për t'u regjistruar përsëri, dhe për këtë arsye ajo kishte statusin e viktimës, për shkak se ndikohej në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ai ligj. Sipas debateve në Parlament, neni 13(2) do të zbatohet për gjyqtarët dhe prokurorët e shkaktuar nga proceset e rivlerësimit. Në vijim, ajo iu referua shembullit të një prokurori tjetër, znj. B. Nikehasani (kërkuësja në kërkesën nr. 58997/18 përpara kësaj Gjykate), kërkesa e së cilës për të nisur procesin për marrjen e licencës për të praktikuar ligjin si avokate, ishte refuzuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë për shkak të shkarkimit të saj në procesin e rivlerësimit.

66. Gjykata u referohet kërkesave të parashikuara në praktikën e saj gjyqësore, në mënyrë që një kërkuës të mund të pretendojë të jetë viktimë e shkeljes së një të drejte të Konventës, sipas kuptimit të nenit 34 të Konventës (shih, *inter alia*, *Tănase kundër Moldavisë* [DHM], nr. 7/08, § 104, GJEDNJ 2010, me referenca të tjera, dhe *Michaud kundër Francës*, nr. 12323/11, § 51, GJEDNJ 2012). Ajo vëren se në çështjen konkrete, është i pakundërshtueshëm fakti se kërkuësja jo vetëm që kishte një licencë që e lejonte atë të praktikonte ligjin si avokate, por ajo edhe u regjistrua pas shkarkimit të saj si prokurore, dhe që prej atij momenti ka praktikuar ligjin si avokate (shih edhe paragrafin 31 më sipër). Organet e rivlerësimit nuk morën asnjë vendim në lidhje me të drejtën e saj për të praktikuar ligjin si avokate. Frika e saj se mund të bëhej viktimë e një shkeljeje të Konventës, duke iu hequr e drejta e avokatisë në të ardhmen nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë nuk është mjaftueshëm që ajo të pretendojë se rrezikon të ndikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 13(2) i Ligjit të Avokateve, dhe se ajo ishte viktimë e shkeljes së të drejtave të saj të Konventës në këtë aspekt (krahaso edhe me *Xboxhaj*, cituar më sipër, §§ 370–73).

67. Për këtë arsye, kjo pjesë e kërkesës është *ratione personae* e papajtuësme me parashikimet e Konventës dhe duhet të rrëzohet në mbështetje të nenit 35 §§ 3 (a) dhe 4.

B. Meritat

1. Nëse shkarkimi i kërkuësës nga detyra përbente një ndërhyrje

68. Duke përsëritur në esencë parashtrimet në lidhje me zbatueshmërinë e nenit 8 të shkarkimit të kërkuësës nga detyra (shih paragrafët 58–59 më sipër), kërkuësja argumentoi se shkarkimi i saj kishte ndërhyrë në të drejtën e saj për respektim të jetës së saj private, ndërsa Qeveria parashtroi se nuk kishte ndodhur një ndërhyrje e tillë.

69. Gjykata është e mendimit se, sipas konstatimeve në lidhje me zbatueshmërinë e nenit 8 (shih paragrafët 61–62 më sipër), shkarkimi i kërkuësës nga detyra, në fakt, përbente një ndërhyrje në të

drejtën e saj për respektim të jetës së saj private (krahaso edhe *Xboxhaj*, cituar më sipër, § 377, me referenca të tjera).

2. Nëse ndërhyrja ishte e justifikuar

a) Në përputhje me ligjin

70. Kërkesja parashitroi se vendimi për ta shkarkuar nga detyra nuk ishte në “përputhje me ligjin”. Parashikimet ligjore mbi të cilat mbështetej ai vendim shpreheshin në terma aq të gjerë sa që ata nuk përmbushnin kërkesën për parashikueshmëri. Veçanërisht, autoritetet vendëse kishin interpretuar në mënyrë të gjerë nenin 61(3) të Ligjit të Rivlerësimit (shih paragrafin 42 më sipër) mbi të cilin ishte mbështetur shkarkimi i saj. Konstatimi për “deklarim të pamjaftueshëm”, sipas nenit 61(3) të Ligjit të Rivlerësimit, lexuar së bashku me nenin 33, çka çonte në shkarkimin nga detyra, duhej të bëhej nëse një person nuk deklaronte plotësisht pasuritë e tij/saj – një konstatim të cilin autoritetet nuk e kishin bërë në çështjen e saj. Në çështjet në të cilat një person nuk justifikon plotësisht vetëm pasuritë e deklaruara – gjë të cilën autoritetet e kishin konstatuar në rastin e saj, pasi ajo nuk kishte mundur të paraqiste prova se bashkëshorti i saj kishte paguar tatimet për disa nga fitimet e tij në të shkuarën – duhet të zbatohet neni 61(1) i Ligjit të Rivlerësimit. Sipas këtij parashikimi, personi i rivlerësuar ishte subjekt shkarkimi nga detyra nëse ai ose ajo kishte deklaruar pasuri në total sa dyfishi i vlerës së pasurive të ligjshme, çka nuk kishte qenë rasti me të. Gjithashtu, neni 61(3) i Ligjit të Rivlerësimit nuk parashikonte se kur deklarimi i pasurive ishte “i pamjaftueshëm”, duke arritur në këtë mënyrë pragun e caktuar si një situatë serioze për të justifikuar shkarkimin nga detyra. Interpretimi i KPA-së i nenit 61(3) të Ligjit të Rivlerësimit nënkuptonte se çdo mangësi mund të interpretohej si “deklarim i pamjaftueshëm”. Kërkesja iu referua edhe opinionit kundërshtues të Vëzhguesit Ndërkombëtar të ONM-së, në lidhje me këtë aspekt (shih paragrafët 27–28 më sipër).

71. Në vijim, kërkesja argumentoi se neni 61(5) i Ligjit të Rivlerësimit, mbi të cilin ishte mbështetur shkarkimi i saj, ishte, gjithashtu, i paqartë, duke u dhënë në këtë mënyrë organeve të rivlerësimit diskrecion të pakufizuar për të shkarkuar nga detyra një person që rivlerësohej. Nuk ekzistonte një përcaktim për parashikimin që një person i rivlerësuar “cenonte besimin e publikut në sistemin e drejtësisë” dhe asnjë tregues se çfarë të metash profesionale arrinin nivelin e caktuar të seriozitetit të situatës për të justifikuar shkarkimin nga detyra. Ishte konstatuar se ajo i kishte përmbushur këto kërkesa pasi nuk kishte respektuar afatin për apelim në një çështje për arsye shëndetësore.

72. Qeveria mbështeti qëndrimin se edhe nëse supozohej se shkarkimi kishte ndërhyrë në të drejtën e kërkueses për respektim të jetës së saj private, ajo ndërhyrje ishte parashikuar nga Kushtetuta dhe Ligji i Rivlerësimit, ku parashikohej qartë procedura e rivlerësimit dhe pasojat e mundshme, duke qenë në këtë mënyrë “në përputhje me ligjin” sipas kuptimit të nenit 8 § 2.

73. Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore të mirëpërcaktuar në lidhje me kushtet që nevojiten që një masë të jetë “në përputhje me ligjin”, duke përfshirë veçanërisht, kërkesën e parashikueshmërisë, që do të thotë se ligji konkret duhet të parashikojë me saktësi të mjaftueshme kushtet sipas të cilave mund të zbatohet masa (shih, *inter alia*, *Maestri kundër Italisë* [DHM], nr. 39748/98, § 30, GJEDNJ 2004-I, dhe *Fernández Martínez kundër Spanjës* [DHM], nr. 56030/07, § 117, GJEDNJ 2014 (ekstrakte)).

74. Në vendimin *Xboxhaj* (cituar më sipër, §§ 385–88), Gjykata vendosi se shkarkimi i kërkuetit në atë çështje, mbështetur në nenin 61(3) dhe (5) të Ligjit të Rivlerësimit, ishte në mbështetje të ligjit sipas kuptimit të nenit 8 § 2.

75. Gjykata vëren se në çështjen konkrete, shkarkimi i kërkueses ishte mbështetur në të njëjtat parashikime të Ligjit të Rivlerësimit. Në vijim, ajo konstaton se sipas praktikës gjyqësore të mirëpërcaktuar të organeve të rivlerësimit, neni 61(3) i Ligjit të Rivlerësimit, duhet të lexohet së

bashku me nenin 33(5) dhe nenin D §§ 1 dhe 3 të aneksit të Kushtetutës (shih paragrafët 40 dhe 38 më sipër). Nga këto parashikime, është e qartë se për qëllime të rivlerësimit, të ardhurat ose burimet e fitimeve të një individi do të konsiderohen të ligjshme vetëm nëse deklarohen në mënyrën e duhur, dhe nëse për to janë paguar tatimet. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se parashikimet ligjore tek të cilat ishte mbështetur shkarkimi i kërkueses përmbushnin kërkesën e parashikueshmërisë. Për këtë arsye, vendimi për ta shkarkuar atë ishte “në përputhje me ligjin”.

b) Qëllim legjitim

76. Sipas këndvështrimit të kërkueses, ndërhyrja në të drejtën e saj për respektim të jetës së saj private, nuk kishte shërbyer për ndonjë qëllim legjitim për qëllime të nenit 8 § 2. Ajo parashtroi, se në praktikë procesi i rivlerësimit ishte përdorur si mjet për t’i shërbyer interesave politikë, duke i frikësuar në mënyrë konstante gjyqtarët dhe prokurorët, gjë e cila dobësonte pavarësinë e tyre.

77. Qeveria argumentoi se ndërhyrja kishte ndjekur qëllimin legjitim për të luftuar korrupsionin në sistemin gjyqësor.

78. Në çështjen *Xboxhaj*, Gjykata konstatoi se masat e parashikuara nga Ligji i Rivlerësimit, i cili ishte miratuar për të siguruar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit gjyqësor dhe rikthimin e besimit të publikut në atë sistem (shih paragrafin 36 më sipër), në përgjithësi u shërbente interesave të sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe mbrojtjes të së drejtave dhe lirive të tjerëve, sipas kuptimit të nenit 8 § 2. Për të arritur në atë përfundim, Gjykata iu referua si raporteve vendëse, edhe atyre ndërkombëtare (veçanërisht atyre të Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO)), duke arritur në përfundimin se ekzistonte një nivel i lartë korrupsioni në sistemin e drejtësisë. Në vijim, ajo mori në konsideratë konstatimet e Gjykatës Kushtetuese dhe të Komisionit Evropian për Demokraci me anë të Ligjit (“Komisioni i Venecias”), se rivlerësimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve ishte i nevojshëm për të mbrojtur sistemin e drejtësisë në Shqipëri nga korrupsioni dhe sfidat e tjera të integritetit dhe profesionalizmit (ibid., §§ 391–93, me referenca të tjera).

79. Gjykata nuk gjen asnjë arsye për të dyshuar se ndërhyrja në të drejtën e kërkueses për të respektuar jetën e saj private duke e shkarkuar atë nga detyra, kishte objektiva të ngjashëm dhe në këtë mënyrë ndiqte qëllimet e mbrojtjes së sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe të drejtave dhe lirive të tjerëve sipas kuptimit të nenit 8 § 2.

c) I nevojshëm në një shoqëri demokratike

i. Parashtrimet e palëve dhe ndërhyrësi si palë e tretë

80. Kërkuësja parashtroi se shkarkimi i saj ishte qartazi joproportional me qëllimin e ndjekur. Ligji i Rivlerësimit (veçanërisht neni 58, shih paragrafin 41 më sipër) nuk parashikonte një nivel sanksionesh dhe rregullash për të garantuar se sanksioni i shkarkimit nga detyra ishte zbatuar në përputhje me parimin e proporcionalitetit (ajo u referua *Oleksandr Volkov kundër Ukrainës*, nr. 21722/11, § 182, GJEDNJ 2013). Për më tepër, nuk ekzistonte asnjë masë mbrojtëse procedurale për të parandaluar zbatimin arbitrar të Ligjit të Rivlerësimit (ajo iu referua *Oleksandr Volkov*, cituar më sipër, § 170). Shkarkimi i saj kishte qenë joproportional në rrethanat e çështjes, duke pasur parasysh argumentet në të cilat ishte mbështetur. Vlerësimi i pasurive ishte mbështetur në faktin se ajo nuk kishte mundur jepte të dhëna se bashkëshorti i saj kishte paguar rregullisht tatimet mbi fitimet e tij në Greqi dhe në Arabinë Saudite, duke përfshirë edhe periudhat në të cilat ajo nuk kishte qenë në marrëdhënie martesore me të. Gjithashtu, në lidhje me këtë aspekt, duhej të mbahej në konsideratë fakti se ligjet shqiptare për tatimet mbi të ardhurat e fituara jashtë vendit nuk kishin qenë të qartë në periudhën përkatëse dhe se bashkëshorti i saj kishte vepruar në mirëbesim. Në lidhje me vlerësimin e kompetencës profesionale, ajo ishte qortuar për mosrespektimin e afatit për apelim në një çështje për arsye shëndetësore.

81. Qeveria argumentoi se shkarkimi i kërkueses nga detyra kishte qenë i nevojshëm në një shoqëri demokratike. Qeveria theksoi se në lidhje me vlerësimin e pasurive, kërkuësja nuk kishte

mundur të provonte burimin e ligjshëm të ALL 3,000,000 dhe EUR 12,000, pasi ajo nuk mund të tregonte se paratë kishin ardhur nga punësimi legjitim dhe se detyrimet e tatimeve ishin shlyer. Në vijim, ajo nuk kishte provuar burimin e ligjshëm të USD 20,000 pasi bashkëshorti i saj nuk kishte paguar tatimet përkatëse. Në vijim, për sa i përket vlerësimit të kompetencës profesionale, ajo nuk kishte apeluar ndaj një vendimi gjykate për të rrëzuar akuzat ndaj një zyrtari të lartë i cili ishte pezulluar për mosdeklarim të pasurive. Në atë kontekst, duhej të mbahej në konsideratë fakti se kërkuësja, si prokurore, kishte qenë drejtuesja e seksionit të krimit ekonomik me fokus evazionin fiskal. Në këtë mënyrë cenohej besimi në sistemin e drejtësisë, nëse një prokurore që akuzonte të tjerët për evazion fiskal apo që nuk apelonte ndaj një vendimi për shfaqësimin e një zyrtari të lartë për evazion fiskal, konstatohej të mos kishte shlyer detyrimet e saj të taksave.

82. *Res Publica*, një organizatë joqeveritare e cila promovonte mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut, argumentonte, veçanërisht, se parashikimi i vetëm dy masave disiplinore në Ligjin e Rivlerësimit, konkretisht shkarkimi nga detyra ose detyrimi për të ndjekur një trajnim, demonstronte mungesën strukturore të proporcionalitetit të sanksioneve disiplinore. Gjithashtu, ndërhyrësi si palë e tretë theksoi se interpretimi i KPA-së i Ligjit të Rivlerësimit nuk linte vend për vlerësimin e proporcionalitetit të sanksioneve në rastin e deklarimeve të parregullta të pasurisë, krahasuar me deklarinimet në të cilat pasuritë fshiheshin me qëllim.

ii. Vlerësimi i Gjykatës

83. Gjykata përsërit se çdo ndërhyrje me të drejtën për të respektuar jetën private do të konsiderohej “e nevojshme në një shoqëri demokratike”, për një qëllim legjitim, nëse i përgjigjet “një nevojë sociale urgjente” dhe, veçanërisht, nëse është proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur, dhe nëse arsyet e dhëna nga autoritetet vendëse për ta justifikuar atë janë “relevante dhe të mjaftueshme” (shih, për shembull, *Fernández Martínez*, cituar më sipër, § 124, dhe *Ivanovski kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, nr. 29908/11, § 180, 21 janar 2016).

84. Duke iu referuar konstatimeve të organeve vendëse dhe ndërkombëtare, të cilat arrinin në përfundimin se ekzistonte një nivel i lartë korrupsioni në sistemin shqiptar të drejtësisë (shih paragrafin 78 më sipër dhe referencat cituar në të), Gjykata thekson se reforma në sistemin e drejtësisë, e cila solli rivlerësimin e jashtëzakonshëm të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë, dhe potencialisht shkarkimin e tyre, erdhi si përgjigje ndaj një “nevojë sociale urgjente” (krahaso edhe *Xboxhaj*, cituar më sipër, § 404).

85. Gjykata vëren se dështime të caktuara nga ana e zyrtarëve publikë për të respektuar detyrimet në lidhje me deklarinimet e pasurive, përgjithësisht, mund të konsiderohen serioze. Këto mund të përfshijnë, midis të tjerash, mosdeklarinimet e pasurive të mëdha ose të burimeve të të ardhurave, ose përpjekjet e qëllimshme për t’i fshehur ato nga autoritetet; pamundësinë për të justifikuar blerjet e mëdha të bëra me kursime dhe burime legjitime dhe të mjaftueshme në zotërim gjatë kohës së përvetësimit; apo pamundësinë për të justifikuar një stil jetese të tepruar apo shpenzime ekstravagante që janë qartazi përtej mjeteve të ligjshme të deklaruara të zyrtarit përkatës dhe të familjes së tij. Gjithashtu, në lidhje me këtë aspekt, Gjykata pranoi se mund të jetë legjitime që të merren në konsideratë edhe të ardhurat dhe deklarinimet e bashkëshortit, partnerit apo anëtarëve të tjerë të familjes së ngushtë të zyrtarit/zyrtares gjatë vlerësimit të respektimit nga ana e zyrtarit/zyrtares të ligjeve antikorrupsion (shih *Samoylova kundër Rusisë*, nr. 491088/11, §§ 85–86, 14 dhjetor 2021). Në të njëjtën kohë, jo çdo rast i vogël mosrespektimi i regjimeve të deklaratave të pasurive, apo çdo mospërputhje e parëndësishme midis shpenzimeve dhe burimeve të ligjshme duhet t’u japë jetë sanksioneve disiplinore të rënda, të tilla si shkarkimi nga detyra.

86. Për sa ka të bëjë me proporcionalitetin midis shkarkimit të kërkuësës dhe qëllimeve legjitime të ndjekura, Gjykata thekson se shkarkimi i saj nga detyra – kryesisht i gjyqtarëve ose i prokurorëve me status jetëgjatë në sistem – është një sanksion i rëndë, në mos më seriozi, që mund të merret ndaj

një individ. Vendosja e një mase të tillë, e cila ndikon negativisht në jetën private të një individ, kërkon marrjen në konsideratë të provave të forta në lidhje me etikën, integritetin dhe kompetencën profesionale të individit (krahaso *Xboxhaj*, cituar më sipër, § 403).

87. Në lidhje me argumentin e kërkuësës se Ligji i Rivlerësimit, në përgjithësi nuk parashikonte një normë sanksionesh dhe rregullash për të garantuar se sanksioni i shkarkimit nga detyra zbatohet në përputhje me parimin e proporcionalitetit, Gjykata vëren se neni E § 1 i Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 58 dhe 66 të Ligjit të Rivlerësimit në të vërtetë parashikonin vetëm dy lloje sanksionesh disiplinore: shkarkimin nga detyra ose pezullimin me detyrimin për të ndjekur një program trajnimi (shih paragrafin 41 më sipër). Në këtë mënyrë, Gjykata i referohet gjykimit të saj në vendimin *Xboxhaj* (cituar më sipër, § 412) se, duke marrë në konsideratë rrethanat e jashtëzakonshme të cilat paraprindë hyrjen në fuqi të Ligjit të Rivlerësimit, është në harmoni me frymën e procesit të rivlerësimit që të ekzistonte një normë më e kufizuar sanksionesh në rastin kur një person nuk përmbushte një nga tri kriteret e vlerësimit të parashikuara në Ligjin e Rivlerësimit. Megjithatë, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse në rrethanat konkrete të çështjes së kërkuësës, zbatimi i këtyre parashikimeve që çonin në vendosjen e sanksionit më të rëndë, ishte proporcional me qëllimet e ndjekura.

88. Shkarkimi i kërkuësës mbështetet në vlerësimin e pasurive të saj dhe në vlerësimin e kompetencës së saj profesionale. Në lidhje me vlerësimin e pasurive, në fillim Gjykata vëren se të gjitha rastet e mosdeklarimit të mjaftueshëm ose të mosjustifikimit të pasurive për qëllime të nenit 61(3) të Ligjit të Rivlerësimit të konstatuara nga KPA-ja kishin lidhje në mënyrë ekskluzive me të ardhurat e fituara nga bashkëshorti i saj nga punësimi jashtë vendit dhe jo me të ardhurat e saj personale. Ajo gjykon se në këto rrethana, është i nevojshëm një kujdes i veçantë për vlerësimin e proporcionalitetit në shkarkimin e saj.

89. Gjykata vëren, se KPA-ja gjykante se kërkuësja nuk kishte deklaruar mjaftueshëm pasuritë sipas kuptimit të nenit 61(3) të lexuar së bashku me nenin 33(5)(b) të Ligjit të Rivlerësimit (shih paragrafët 42 dhe 40 më sipër), pasi ajo nuk kishte provuar ligjshmërinë e burimeve financiare të përdorura për të përfutur një pjesë të pasurive të paluajtshme të çiftit (shih paragrafët 13–22 më sipër). Sipas gjykimit të KPA-së, ajo nuk kishte mundur të provonte ligjshmërinë e burimeve të mëposhtme të të ardhurave të përdorura për të blerë një pronë të paluajtshme: ALL 3,000,000 (rreth EUR 22,000 në atë kohë) të fituara nga bashkëshorti i saj i ardhshëm si emigrant në Greqi nga viti 1997 në vitin 2000; EUR 12,000 të fituara nga bashkëshorti i saj në Arabinë Saudite në vitin 2003; dhe USD 20,000 të fituara nga bashkëshorti i saj në Arabinë Saudite në vitin 2006.

90. Për sa u përket parregullsive në lidhje me ALL 3,000,000 të fituara nga bashkëshorti i ardhshëm i kërkuësës si emigrant në Greqi gjatë viteve 1997–2000, sipas gjykimit të KPA-së, kërkuësja nuk kishte paraqitur prova për punësimin e tij në Greqi në atë kohë, dhe as nuk kishte paraqitur shumën e saktë të të ardhurave të gjeneruara nga puna e tij (shih paragrafët 15–17 më sipër). Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata vëren se ndryshe nga KPK-ja, KPA-ja shqyrtoi të ardhurat që bashkëshorti i ardhshëm i kërkuësës i kishte fituar pesëmbëdhjetë–njëzet vjet përpara deklarimit të saj në procesin e rivlerësimit, në një periudhë kur ai nuk ishte martuar ende me të, gjithashtu, Gjykata vëren se është i rëndësishëm fakti se ajo nuk ishte bërë ende prokurore apo zyrtare publike i një roli tjetër që t'u nënshtrohej ligjeve për deklarimin e pasurive.

91. Për sa u përket parregullsive në lidhje me EUR 12,000 të fituara nga bashkëshorti i kërkuësës në Arabinë Saudite në vitin 2003, sipas gjykimit të KPA-së, kishte indicie për punësimin e tij në Arabinë Saudite në atë periudhë. Megjithatë, kërkuësja nuk i kishte deklaruar këto të ardhura më herët në deklaratën e saj të rivlerësimit dhe as nuk kishte provuar se bashkëshorti i saj kishte paguar tatimet për këto të ardhura (shih paragrafin 18 më sipër). Gjykata mban në konsideratë faktin se kërkuësja nuk e kishte deklaruar këtë shumë në vitin 2004 në deklaratën e përvitshme të pasurisë,

përpara se ta deklaronte në deklaratën e rivlerësimit. Në lidhje me këtë aspekt, ajo gjykon se ky mosdeklarim ka të bëjë me deklarimin e parë të pasurisë së kërkueses, e cila kishte nisur të praktikonte ligjin si prokurore vetëm në tetor 2003. Në lidhje me materialet përpara saj, në vijim, ajo gjykon se nuk ekziston asgjë që të tregojë se të ardhurat e bashkëshortit nuk vinin nga një aktivitet fitimprurës i ligjshëm.

92. Në lidhje me parregullsitë me paratë e fituara nga bashkëshorti i ankueses në Arabinë Saudite në vitin 2006 (USD 20,000), kërkuesja ofroi prova të besueshme se ai kishte qenë i punësuar në atë periudhë në Arabinë Saudite dhe deklaroi shumën e fituar në deklaratën e saj të përvitshme të pasurisë për vitin 2006 dhe në deklaratën e saj të rivlerësimit, por nuk ofroi prova të dokumentuara se ai i kishte paguar tatimet mbi të ardhurat në Shqipëri ose në Arabinë Saudite (shih paragrafët 19–21 më sipër). Gjithashtu, Gjykata vëren se në lidhje me këto të ardhura nuk ka asgjë për të treguar se ato nuk vinin nga një aktivitet i ligjshëm fitimprurës.

93. Në lidhje me konstatimet e mësipërme, Gjykata thekson se kërkuesja ishte shkarkuar nga detyra, pasi ishte konstatuar se ajo nuk kishte mjaftueshëm burime të ligjshme për të justifikuar përvetësimin e pasurisë së paluajtshme. Vlerësimi i burimeve – ekskluzivisht të ardhurat e bashkëshortit të saj – përfshinin të ardhurat e fituara prej tij në kohën kur kërkuesja nuk ishte as e martuar me të dhe as një prokurore. Burimet e tjera nuk ishin konsideruar të ligjshme, kryesisht pasi kërkuesja nuk kishte mundur të provonte se bashkëshorti i saj kishte paguar taksat për të ardhurat e tij nga një punësim i ligjshëm jashtë vendit. Gjykata vëren se, teksa evazoni i mundshëm fiskal është një çështje serioze, për qëllimet e procedurave të rivlerësimit të kërkueses, është me rëndësi për çështjen që shumatat e të ardhurave të bashkëshortit për të cilat nuk u provua nëse tatimet ishin paguar, përfaqësonin një përqindje relativisht të vogël të shumës në total të të ardhurave të bashkëshortit në periudhën konkrete, dhe se nuk u konstatua asnjë parregullsi në lidhje me të ardhurat e bashkëshortit nga burimet vendëse gjatë një sërë vitesh.

94. Në lidhje me vlerësimin e kompetencës profesionale të kërkueses, qasja e vetme që KPA-ja kishte kundër saj ishte fakti se ajo nuk kishte respektuar një afat për dorëzimin e apelimit në një çështje. E teksa vetë KPA-ja e kishte konsideruar këtë rast një incident të izoluar në karrierën e kërkueses, sidoqoftë, ajo gjykoj se duke qenë se çështja konkrete kishte të bënte me deklarimin e pasurive të një zyrtari publik, mosdorëzimi nga ana e saj i një apelimi ndikonte në cenimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, për qëllimet e nenit 61(5) të Ligjit të Rivlerësimit (shih paragrafët 23–25 më sipër). Gjykata nuk nënvlerëson në këtë këndvështrim rëndësinë e ndjekjes penale të veprave penale të pretenduara me natyrë ekonomike nga zyrtarët publikë për ruajtjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Megjithatë, ajo gjykon se, për sa më sipër, në këndvështrimin e KPA-së, mosdorëzimi nga ana e kërkueses e një apelimi kishte qenë një incident i izoluar në karrierën e saj si prokurore, e cila kryesisht trajtonte rastet e krimeve ekonomike. Nuk është argumentuar nëse çështja konkrete, e cila përfshinte një ish-zyrtar të qeverisë lokale, ishte e një profili veçanërisht të lartë. Gjithashtu, në lidhje me këtë aspekt, Gjykata i referohet opinionit të vëzhguesit ndërkombëtar, se apelimi konkret do të duhej të dorëzohej duke pasur në konsideratë udhëzimet e përgjithshme për paraqitjen e apelimeve të prokurorisë, por ky apelim nuk kishte pasur ndonjë perspektivë të arsyeshme për të pasur sukses.

95. Në vijim, Gjykata i referohet faktit se sipas ligjit vendës (krahaso paragrafët 47–49 më sipër) dhe standardeve evropiane, duke përfshirë Udhëzimet Evropiane për Etikën dhe Sjelljen për Prokurorët Publikë (“Udhëzimet e Budapestit”, shih paragrafin 51 më sipër) si edhe opinionin vijues nr. 13 (2018) për pavarësinë, llogaridhënien dhe etikën e profesorëve, lëshuar nga Këshilli Konsultativ i Prokurorëve të Evropës, të Këshillit të Evropës (CCPE) (shih paragrafin 52 më sipër), prokurorët duhet të përmbushin standarde të larta integriteti në trajtimin e çështjeve të tyre private jashtë profesionit për të ruajtur besimin e publikut në integritetin e sistemit të drejtësisë. Për këtë

arsye, është e rëndësishme që kërkuësja, si prokurore përgjegjëse për ndjekjen penale, *inter alia*, të kundërvajtoje tatimore, të provojë se pjesëtarët e familjes së saj të ngushtë kishin respektuar legjislacionin e zbatueshëm tatimor. Gjykata nuk mund të anashkalojë faktin se një formë më pak e rëndë për përgjegjësinë tatimore, jashtë procesit të rivlerësimit, mund të ishte marrë në konsideratë në një rast të tillë. Për më tepër, çdo indicie për evazion fiskal do të ishte hetuar nga autoritetet përkatëse. Megjithatë, rrethanat konkrete të çështjes duhet të merren në konsideratë për të vlerësuar proporcionalitetin e sanksionit më të rëndë: shkarkim nga detyra. Në rastin e kërkuësës, sanksioni konkret, sipas Ligjit për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, sillte edhe ndalimin e përhershëm për t'u rikthyer në sistemin e drejtësisë (krahaso *Xboxhaj*, cituar më sipër, §§ 413, 245 dhe 206-07).

96. Për sa më sipër, Gjykata gjykon se referuar një vlerësimi të përgjithshëm të rrethanave specifike të çështjes, shkarkimi i kërkuësës, mbështetur kryesisht në faktin se ajo nuk kishte mundur të provonte se bashkëshorti i saj i kishte paguar tatimet për një pjesë të të ardhurave të tij nga aktivitete të ligjshme gjatë dy dekadave të mëparshme, dhe në mungesë të ndonjë indicie të keqbesimit apo të shkeljeve të qëllimshme nga vetë kërkuësja, ishte joproporcional me qëllimet legjitime të procesit të rivlerësimit.

97. Sipas këtyre rrethanave, me shkarkimin e kërkuësës nga detyra është shkelur neni 8 i Konventës.

III. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 6 TË KONVENTËS

98. Kërkuësja u ankua se procedurat e rivlerësimit që kishin rezultuar në shkarkimin e saj nga posti i prokurores kishin qenë të padrejta. Ajo argumentoi se çështja e saj nuk ishte gjykuar nga një “gjykatë e krijuar nga ligji” për shkak të mospërshtatshmërisë së njërit apo më shumë anëtarëve të KPA-së, se KPA-ja që kishte gjykuar çështjen e saj nuk kishte pavarësi dhe paanshmëri, dhe se të meta të rënda procedurale kishin ndikuar në drejtësinë e procesit. Ajo u mbështet në nenin 6 të Konventës, pjesët përkatëse të të cilit parashikojnë, si më poshtë:

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij...”

A. Zbatueshmëria e nenit 6

99. Qeveria pranoi se neni 6 § 1 i Konventës ishte i zbatueshëm për proceset e rivlerësimit në aspektin e tij civil. Kërkuësja ishte e mendimit se neni 6 ishte i zbatueshëm për ato procese si në aspektin e tij civil edhe atë penal.

100. Në vendimin *Xboxhaj* (cituar më sipër), Gjykata konstatoi se neni 6 ishte i zbatueshëm në procesin e rivlerësimit të prezantuar në Shqipëri në vitin 2016, në aspektin e tij civil (ibid., §§ 236-39 dhe 288), por jo në aspektin e tij penal (ibid., §§ 240-46). Ajo nuk sheh asnjë arsye të arrijë një përfundim ndryshe në këtë çështje.

B. Ankesa në lidhje me përcaktimin e të drejtave nga një “gjykatë e krijuar nga ligji”

1. Parashtrimet e palëve

101. Qeveria parashtrroi se ankesa e kërkuësës ku pretendohet për papërshtatshmërinë e një sërë gjyqtarësh të KPA-së për detyrën e gjyqtarit dhe, për pasojë, për mungesën e një “gjykate të krijuar nga ligji”, duhet të rrezohet për mosshfrytëzim të mjeteve vendëse në përputhje me nenin 35 § 1 të Konventës. Qeveria parashtrroi se ajo nuk kishte paraqitur asnjë kundërshtim për përbërjen e KPA-së gjatë procesit përpara atij kolegji, dhe për këtë arsye, nuk u kishte dhënë gjykatave vendëse mundësinë të korrigjonin një gabim të mundshëm.

102. Qeveria argumentoi se sipas nenit 27 të Ligjit të Rivlerësimit (shih paragrafin 43 më sipër), kërkuësja kishte pasur mundësinë të kundërshtonte praninë në proces të gjyqtarëve, të cilët ishin në konflikt interesi ose nuk kishin mundësi të ushtronin detyrën për shkak të ndalimeve të caktuara.

Sipas nenit 27(2) të Ligjit të Rivlerësimit, në rastin e një kundërshtimi, vendimi do të merrej nga një tjetër trup gjykues i KPA. Në vijim, Qeveria argumentoi se edhe një person tjetër subjekt i procesit të rivlerësimit kishte paraqitur një ankesë penale ndaj njërit prej gjyqtarëve të KPA, L.D., i cili ishte pezulluar nga detyra nga KPA pasi ishte akuzuar për falsifikim të dokumenteve (shih paragrafin 34 më sipër).

103. Kërkuesja parashtrroi se ajo nuk kishte pasur mjete efektive në dispozicion për të kundërshtuar përbërjen e KPA-së gjatë procesit të rivlerësimit. Vendimet e KPA-së ishin të formës së prerë. Vetëm tre muaj pas vendimit të KPA-së për ta shkarkuar nga detyra, u zbulua se dy ose më shumë gjyqtarë të KPA nuk kishin qenë të kualifikueshëm për të shërbyer si gjyqtarë të këtij kolegj. Njëri prej gjyqtarëve, L.D. më pas ishte shpallur fajtor pasi kishte fshehur faktin që çonte në papërshtatshmërinë e tij, më konkretisht faktin se ishte shkarkuar nga detyra si gjyqtar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë në vitin 1997. Në vijim, ai ishte skualifikuar nga kandidimi për një tjetër pozicion në gjyqësor nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë në fund të vitit 2016.

104. Në vijim, kërkuesja parashtrroi se nuk kishte pasur asnjë mjet efektiv për të kundërshtuar mosrespektimin e kriterëve të kualifikimit nga ana e anëtarëve të KPA-së. Një person tjetër, subjekt i procesit të rivlerësimit, kishte kundërshtuar pjesëmarrjen e gjyqtarëve L.D. dhe A.H. në çështjen e tij pasi ata nuk përmbushnin kriteret përzgjedhëse për të qenë anëtarë të KPA. Megjithatë, KPA-ja kishte gjykuar se pyetjet në lidhje me mandatin e këtyre gjyqtarëve nuk ishin në juridiksionin e saj, sipas parashikimeve kushtetuese të zbatueshme. Edhe ankesa kushtetuese e këtij personi nuk kishte pasur ndonjë dobi (shih paragrafët 44–45 më sipër). Kërkesat e saj për hapjen e një procesi disiplinor ndaj gjyqtarëve L.D. dhe A.H., dhe heqja e tyre nga detyra për arsye mospërshtatshmërie në KPA dhe ONM, pasi ajo ishte vënë në dijeni për problemet me mospërshtatshmërinë e tyre, nuk kishin pasur dobi (shih paragrafët 32–33 më sipër).

2. Vlerësimi i Gjykatës

105. Gjykata përsërit se një tipar themelor i mekanizmit për mbrojtjen e krijuar nga Konventa është delegimi te sistemet vendëse që të ruajnë të drejtat e njeriut. Gjykata nuk duhet të marrë rolin e Shteteve Kontraktuese, përgjegjësia e të cilave është të garantojnë respektimin dhe mbrojtjen në nivel vendës të të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Konventë. Rregulli për shterimin e mjeteve vendëse mbështetet në prezumimin – reflektuar në nenin 13 të Konventës, me të cilin ka më shumë ngjashmëri – se ekziston një mjet efektiv i disponueshëm për shkeljen e pretenduar. Për këtë arsye, rregulli është një pjesë e rëndësishme e funksionimit të këtij sistemi mbrojtjeje (shih *Vučković dhe të Tjerët kundër Serbisë* (kundërshtimi paraprak) [DHM], nr. 17153/11 dhe 29 të tjerë, § 69, 25 mars 2014).

106. Shtetet nuk përgjigjen përpara një organi ndërkombëtar për veprimet e tyre përpara se të kenë pasur mundësinë t'i zgjidhin problemet me anë të sistemit të tyre ligjor, dhe ato shtete që dëshirojnë të kërkojnë juridiksionin mbikëqyrës të Gjykatës për sa u përket ankesave kundër një Shteti kanë detyrimin të përdorin fillimisht mjetet e ofruara nga sistemi vendës ligjor (shih, midis shumë autoritetesh, *Akdinar dhe të Tjerët*, § 65, dhe *Vučković dhe të Tjerët*, § 70, të dy cituar më sipër).

107. Dyshimet mbi rolin e kërkuesit/kërkueses në lidhje me efikasitetin e një mjeti të caktuar nuk e çlirojnë atë nga detyrimi që ta provojë atë (shih *Milošević kundër Holandës* (vendim) nr. 77631/01, 19 Mars 2002; *Vučković dhe të Tjerët*, cituar më sipër, §§ 74 dhe 84; dhe *Zibni kundër Turqisë* (vendim), nr. 59061/16, §§ 23 dhe 30, 29 nëntor 2016). Kjo është e vërtetë veçanërisht në kontekstin në të cilin efikasiteti i një mjeti nuk është testuar ende ose testohet rrallë përpara gjykatave vendëse, dhe në kontekstin në të cilin Gjykata ka vendosur se kërkuesit do të duhej të shteronin mjetet të cilat ishin të aksesueshme dhe që ofronin perspektiva të arsyeshme suksesi (krahaso *Zibni*, cituar më sipër, §§ 24–31). Në një sistem ligjor ku ofrohet mbrojtje nga Kushtetuta ose ligji për të drejtat themelore, është detyra e individit të dëmtuar të testojë atë mbrojtje dhe t'i lejojë gjykatat vendëse t'i mbrojnë

ato të drejta me anë të interpretimit (krahaso, *A, B dhe C kundër Irlandës* [DHM], nr. 25579/09, § 142, GJEDNJ 2010; shih edhe *Vučković dhe të Tjerët*, § 84, dhe *Zini*, § 30, të dy cituar më sipër).

108. Në lidhje me vendimet e formës së prerë shpallur nga gjykatat vendëse, Gjykata ka vendosur vazhdimisht se një kërkesë për rihapjen e proceseve mbi bazën e fakteve të reja nuk është një mjet efektiv për qëllimet e respektimit të kriterëve të pranueshmërisë sipas nenit 35 § 1 të Konventës (shih *Vainio kundër Finlandës* (vendim), nr. 62123/09, 3 maj 2011; *Riedl-Riedenstein dhe të Tjerët kundër Gjermanisë* (vendim), nr. 48662/99, 22 janar 2002; dhe *Dinchev kundër Bullgarisë* (vendim), nr. 17220/09, § 27, 21 nëntor 2017). Megjithatë, Gjykata ka vendosur edhe se në disa situata të caktuara përjashtuese, duhet të rivendosen mjete të jashtëzakonshme, për shembull, në rastin kur rrëzimi i një vendimi i cili ka hyrë në fuqi, është i vetmi mjet me anë të të cilit Shteti përgjegjës mund të zgjidhë çështjet me anë të sistemit të tij ligjor (shih *Kiiskinen dhe Kovalainen kundër Finlandës* (vendim), nr. 26323/95, 1 qershor 1999, ku ankimi përpara Gjykatës kishte të bënte me paanshmërinë e një gjyqtari dhe nuk do të mund të ishte bërë përpara përfundimit të procesit vendës; dhe *Nikula kundër Finlandës* (vendim), nr. 31611/96, 30 nëntor 2000). Në mënyrë të ngjashme, në rrethana specifike, Gjykata ka vendosur se një kërkesë për rihapjen e proceseve mund të jetë i vetmi mjet përmes së cilit ankesa specifike mund të ngrihet përpara gjykatave vendëse dhe në rrethana të tilla, kjo do të përbënte një mjet efektiv (shih *Sobczyk kundër Polonisë* (vendim), nr. 73446/10, §§ 40 dhe 48, 25 gusht 2015, dhe *Dinchev*, cituar më sipër, § 28).

109. Gjykata vëren se është i pakundërshtueshëm fakti se ankuesja nuk e bëri ankesën e saj në lidhje me faktin se një apo më shumë gjyqtarë të KPA-së nuk përmbushnin kriteret kualifikuese për të shërbyer si gjyqtarë të atij kolegji në procesin e rivlerësimit përpara atij kolegji. Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata gjykon se Gjykata Kushtetuese, në vendimin e saj të datës 29 prill 2020, në çështjen *Besnik Cani* (shih paragrafët 44–45 më sipër), konfirmoi se e drejta kushtetuese për “një gjykatë të krijuar nga ligji” duhej të garantohej nga KPA-ja gjatë proceseve përpara tij (ibid, m §§ 21 dhe 24). Në vijim, ajo vëren se diku pas vendimit të KPA-së për çështjen e saj, KPA-së e pezulloi Gjyqtarin L.D. nga detyra, kur ndaj tij nisi procesi penal për falsifikim dokumentesh në lidhje me aplikimin e tij për pozicionin në KPA, pas një ankese penale nga një person tjetër që po rivlerësohej (shih paragrafin 34 më sipër).

110. Gjykata vëren se një palë në një proces gjyqësor e cila ka dyshime për ligjshmërinë e emërimit të një gjyqtari që merr pjesë në seancën e çështjes së tij/saj, çka mund të ndikojë negativisht në cilësinë e parimit “të themeluar nga ligji” të asaj gjykate, përgjithësisht pritet t’i drejtojë ato pyetje përpara gjykatës dhe/ose të ndjekë çdo mjet tjetër efektiv të parashikuar nga ligji vendës teksa procesi është ende në pritje (krahaso faktet në vendimin *Besnik Cani*, cituar më sipër, §§ 35–42). Faktet referuar nga kërkuësja në fjalë në lidhje me përshtatshmërinë e L.D. për të shërbyer si gjyqtar i KPA, dhe veçanërisht shkarkimi i tij i mëparshëm nga detyra në gjyqësor, ishin publike. Kërkuësja ka referuar vendimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili e shkarkoi L.D. nga detyra në vitin 1997 dhe, gjithashtu, e skualifikonte atë nga kandidimi për një pozicion tjetër në gjyqësor në fund të vitit 2016, dokumente të cilat ajo i mori brenda disa muajsh pas shkarkimit të saj në procesin e rivlerësimit. Edhe anëtarët e komisionit parlamentar që shqyrtuan aplikimin e L.D. për pozicionin në KPA ngritën pyetje gjatë seancës parlamentare për situatat e tij të mëparshme (shih *Besnik Cani*, cituar më sipër, § 13). Në këto rrethana, kërkuësja nuk provoi bindshëm se nuk mund të kishte dijeni gjatë procesit të saj të rivlerësimit për faktet kyçe në lidhje me largimin e mëparshëm të L.D. nga gjyqësori.

111. Gjithashtu, si konsideratë shtesë, kërkuësja nuk paraqiti, pas vënies në dijeni për dyshimet në lidhje me përshtatshmërinë e L.D. për pozicionin e tij, një kërkesë për rishikim përjashtimor të vendimit të formës së prerë të KPA-së në çështjen e saj mbështetur në faktet e zbuluara rishtazi, apo për ndonjë shkak tjetër të parashikuar në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile (shih paragrafin 46

më sipër dhe vendimin *Besnik Cani*, cituar më sipër, §§ 148–49). Kjo do t'i kishte dhënë kërkuases një mundësi për të bërë parashtrime përpara KPA pas hedhjes dritë mbi të dhënat e reja dhe vendimtare, dhe për të shprehur vëmendjen ndaj këtij aspekt (më konkretisht, se këto fakte “nuk mund të ishin bërë të njohura nga pala gjatë shqyrtimit të çështjes”), si edhe për t'i dhënë KPA-së një mundësi për t'i marrë në konsideratë ato parashtrime.

112. Gjykata nuk e anashkalon faktin se përderisa çështja e kundërshtimit të përshtatshmërisë së gjyqtarëve të KPA ishte një çështje e re në proceset e rivlerësimit, nuk ekzistonte ende ndonjë praktikë e mirëpërcaktuar gjyqësore, sipas së cilës kërkuesi mund të përdorte ndonjë mjet apo mjete. Për më tepër, Gjykata i referohet konstatimeve të saj në çështjen *Besnik Cani* (cituar më sipër, §§ 35–36), ku KPA u vetëdeklarua jokompetente për të marrë një vendim për ankesën e kërkuarit – një çështje e paraqitur pasi vendimi i KPA-së për të shkarkuar kërkuar nga detyra e saj ishte bërë i formës së prerë – se mandati i L.D. duhet të ndërpritet për shkak të papërshtatshmërisë së tij për detyrën në KPA. Megjithatë, Gjykata është e mendimit se këto zhvillime të mëpasshme, për të cilat ankuesja nuk kishte dijeni në kohën përkatëse, nuk e përjashtonin atë nga detyra për të ngritur pikëpyetjet përkatëse ose gjatë procesit të saj të rivlerësimit, apo nëse kjo nuk ishte e mundur objektivisht pavarësisht kujdesit të saj, me anë të nisjes së procesit për rishikim të vendimit të formës së prerë të KPA-së. Në këtë aspekt, Gjykata nuk mund të përjashtojë se pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese të datës 29 prill 2020 (shih paragrafët 44–45 më sipër), KPA-së do të mund ta kishte rishqyrtuar – nëse do t'i kërkohej ta bënte këtë gjë në proces formal – pozicionin e saj të mëparshëm për mungesën e kompetencës për të dëgjuar kundërshtimet ndaj përshtatshmërisë së njërit prej anëtarëve të saj për një pozicion në gjyqësor. Si përfundim, kërkuarja nuk përdori ndonjë mjet vendës për garantimin e të drejtës së saj që procesi i saj i rivlerësimit të gjykohej nga një “gjykatë e krijuar nga ligji”. Gjatë procesit përpara KPA-së, ajo nuk e ngriti kundërshtimin e saj për përbërjen e KPA, sipas rregullave të zakonshme të procedurës civile, apo mbi ndonjë shkak tjetër (krahaso faktet në vendimin *Besnik Cani*, cituar më sipër, § 35–39). Në vijim, Gjykata vlerëson se kërkesat e dorëzuara për informacion dhe procedurat disiplinore të kërkuara nga kërkuarja ndaj gjyqtarëve në fjalë pas përfundimit të procesit të rivlerësimit ndaj saj me anë të një vendimi të formës së prerë nuk ishin një mjet efektiv për të garantuar se çështja e saj do të gjykohej nga një “gjykatë e krijuar me ligj”.

113. Në këto rrethana, kundërshtimi i Qeverisë duhet të lejohet dhe kjo pjesë e kërkesës duhet të rrëzohet për mosshfrytëzim të mjeteve vendëse sipas nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

C. Ankesat në lidhje me pavarësinë dhe paanshmërinë e KPA-së

114. Qeveria parashtroi se kërkuarja nuk ishte ankuar për mungesë pavarësie dhe paanshmërie të KPA-së në vendimarrjen ndaj çështjes së saj në procesin përpara gjykatës, dhe në këtë mënyrë nuk kishte shteruar mjetet vendëse për këtë aspekt sipas qëllimeve të nenit 35. Në vijim, Qeveria parashtroi se, për çdo rast, për sa i përket mënyrës së zgjedhjes, përbërjes dhe garancive procedurale, KPA-ja kishte përmbushur kërkesat për një gjykatë të pavarur dhe të paanshme. Shumica e anëtarëve të KPA-së, të përzgjedhur si gjyqtarë të nivelit të Gjykatës Kushtetuese nga Parlamenti shqiptar, në të shkuarën kishin ushtruar funksione gjyqësore.

115. Kërkuarja parashtroi se KPA-së i mungonte pavarësia dhe paanshmëria kryesisht për tri arsye: së pari, nuk kishte përfaqësim substancial të gjyqtarëve në KPA, dhe anëtarët e KPA-së nuk ishin mjaftueshëm të kualifikuar për të trajtuar proceset komplekse të rivlerësimit; së dyti, për sa ka të bëjë me procesin e emërimit, KPA-ja përbëhej nga anëtarë të përzgjedhur nga një organ parlamentar i posaçëm dhe të emëruar nga Parlamenti, pa përfshirjen e gjyqësorit, dhe për këtë arsye, ishin të ekspozuar ndaj presionit politik. Së treti, ekzistonte një konfuzion midis rolit të organeve të rivlerësimit në hetime dhe rolit të tyre në vendimin pasues për meritat e akuzave, gjë e cila krijonte pasiguri objektivisht të justifikueshme për paanshmërinë e KPA-së.

116. Edhe ndërhyrësi si palë e tretë, *Res Publica*, ishte i mendimit se anëtarët e organeve të rivlerësimit nuk kishin të gjithë trajnimin juridik dhe eksperiencën e nevojshme për të trajtuar procese disiplinore shumë komplekse ndaj gjyqtarëve.

117. Në vendimin e saj udhëheqës, në çështjen *Xboxhaj* (cituar më sipër), Gjykata vendosi, së pari, se mospërfaqësimi i gjyqtarëve në detyrë në KPA, duke marrë në konsideratë natyrën e jashtëzakonshme të proceseve të rivlerësimit, ku shenjestrohen të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë për të luftuar korrupsionin, si edhe masat statutore mbrojtëse për pavarësinë e anëtarëve të KPA, nuk përbënte mungesë pavarësie në atë kolegji (shih *Xboxhaj*, cituar më sipër, §§ 314 dhe 316, lexuar së bashku me §§ 299–300). Së dyti, Gjykata arriti në përfundimin se përgjithësisht nuk kishte arsye për të dyshuar në pavarësinë e organeve të rivlerësimit duke iu referuar mënyrës së emërimit të anëtarëve të tyre, më konkretisht zgjedhja e tyre nga Parlamenti (ibid., §§ 311 dhe 295–96). Së treti, Gjykata arriti në përfundimin se, duke marrë në konsideratë funksionimin e proceseve të rivlerësimit, nuk kishte konfuzion midis detyrimit të organeve të rivlerësimit (dhe veçanërisht të KPK-së) për të nisur një hetim, dhe detyrës së tyre për të marrë një vendim për përgjegjësinë disiplinore të personit të rivlerësuar, dhe për pasojë, nuk kishte pasiguri të justifikuar objektivisht në lidhje me paanshmërinë e organeve të rivlerësimit (shih *Xboxhaj*, cituar më sipër, §§ 315 dhe 305–308).

118. Duke pasur parasysh këto konstatime, rrethanat e çështjes së kërkuarit dhe parashtrimet e saj, të cilat janë të krahasueshme me ato të bëra në çështjen *Xboxhaj*, Gjykata, duke marrë në konsideratë edhe shterimin e mjeteve vendëse në këtë aspekt, gjykon se nuk rezulton të ketë mungesë të pavarësisë dhe paanshmërisë në KPA në rastin e çështjes së kërkuarës.

119. Për pasojë, kjo pjesë e kërkesës duhet të kundërshtohet si qartazi e pambështetur në fakte, në mbështetje të nenit 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

D. Ankesë në lidhje me kohën e nevojshme dhe lehtësitë për të paraqitur çështjen

120. Në vijim, kërkuarja u ankua se kishte pasur mangësi të rënda procedurale në procesin e rivlerësimit ndaj saj. Veçanërisht, asaj nuk i ishte ofruar mjaftueshëm mundësi dhe kohë për ta paraqitur çështjen dhe provat e saj përpara KPA-së për të kundërshtuar shkarkimin.

121. Qeveria e kontestoi këtë qëndrim. Ajo parashtrroi veçanërisht se kërkuarja kishte pasur mundësi ta paraqiste çështjen e saj, të caktonte dëshmitarë apo ekspertë dhe të dorëzonte prova të reja në seancat përpara KPA-së. Ajo nuk kishte kërkuar kohë shtesë apo shtyrje të seancës për të paraqitur argumentet e saj.

122. Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata vëren se pas apelimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të KPK-së, kërkuarësja i ishte ofruar akses në dosjen e çështjes dhe kishte pasur mundësi të bënte parashtrime dhe të paraqiste prova gjatë seancave dëgjimore publike përpara KPA-së (shih paragrafin 12 më sipër). Duke pasur parasysh materialet përpara saj, gjykata nuk gjen indicie se kërkuarja nuk pati kohën dhe lehtësitë për të paraqitur në mënyrën e duhur argumentet e saj.

123. Për këtë arsye, kjo pjesë e kërkesës duhet të kundërshtohet si qartazi e pambështetur në fakte, në mbështetje të nenit 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

E. Ankesë në lidhje me zbatimin e ligjit vendës

124. Kërkuarja u ankua edhe për faktin se KPA-ja kishte zbatuar ligjin vendës në një mënyrë dukshëm të gabuar. Qeveria e kontestoi këtë qëndrim.

125. Gjykata përsërit se nuk është detyra e saj të marrë rolin e gjykatave vendëse. Kryesisht u takon autoriteteve vendëse, veçanërisht gjykatave, të zgjidhin problemet me interpretimin e legjislacionit vendës. Roli i saj është të verifikojë nëse efektet e një interpretimi të tillë janë në përputhje me Konventën. Thënë kjo, me përjashtim të rasteve të një arbitrariteti të dukshëm, nuk është roli i Gjykatës që të verë në pikëpyetje interpretimin e ligjit vendës nga gjykatat vendëse (shih *Nejdet Šahin dhe Perihan Šahin kundër Turqisë* [DHM], nr. 13279/05, §§ 49–50, 20 tetor 2011, në referenca të mëtejshme, dhe *Andelković kundër Serbisë*, nr. 1401/08, § 24, 9 prill 2013).

126. Gjykata vëren se, teksa ajo ka konstatuar se zbatimi i ligjeve të rivlerësimit nga gjykatat vendëse në rrethanat e kësaj çështje çonin në shkelje të nenit 8 të Konventës (shih paragrafët 83–97 më sipër), ky zbatim nuk mund të konsiderohet si qartazi arbitrar.

127. Më tej, ajo vijon se kjo pjesë e kërkesës duhet të kundërshtohet si qartazi e pambështetur në fakte, në mbështetje të nenit 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

F. Ankesë në lidhje me barrën e provës

128. Në vijim, kërkuesi u ankua se barra e provës ndaj saj në procesin e rivlerësimit ishte e paarsyeshme.

129. Qeveria e kontestoi atë këndvështrim.

130. Për sa i përket ankesës së kërkueses, në lidhje me barrën e provës ndaj saj, Gjykata përsërit se neni 6 i Konventës nuk parashikon ndonjë rregull për pranueshmërinë e provave, apo për mënyrën se si provat duhet të vlerësohen, çka janë kryesisht çështje që duhet të rregullohen nga ligji vendës dhe gjykatat vendëse (shih, midis shumë autoriteteve të tjera, *García Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, § 28, GJEDNJ 1999-I). U takon gjykatave vendëse të vlerësojnë relevancën e të dhënave të propozuara, vlerën e tyre provuese dhe barrën e provës (shih *Centro Europa 7 S.r.l. dhe Di Stefano*, cituar më sipër, § 198; *Lady S.R.L. kundër Republikës së Moldavisë*, nr. 39804/06, § 27, 23 tetor 2018; dhe *Xboxhaj*, cituar më sipër, § 325). Në vijim, ajo u referohet konstatimeve të saj në çështjen *Xboxhaj*, se në përgjithësi, rregullat e barrës së provës në procedura sipas Ligjit të Rivlerësimit, duke përfshirë mungesën e kufijve të rreptë kohor për vlerësimin e pasurive, nuk paraqesin një shkelje të nenit 6 sipas aspektit të parimit të sigurisë ligjore, por se interpretimi i këtyre parashikimeve për siguri ligjore dhe të drejtat e një kërkuesi sipas nenit 6 § 1 duhet të shqyrtohen rast pas rasti (ibid., §§ 348–53).

131. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se ngjarjet në lidhje me punësimin e bashkëshortit të ardhshëm të ankueses në Greqi faktikisht kthehen ndjeshëm pas në kohë. Megjithatë, ato konsiderohen të provuara të paktën deri në një masë të caktuar. Në lidhje me ligjshmërinë e të ardhurave të bashkëshortit nga dy periudha punësimi në Arabinë Saudite, nuk duhet të konsiderohet e tepruar që kërkuësja, si prokurore me eksperiencë e krimeve financiare, pritej të tregonte se tatimi mbi të ardhurat ishte paguar në kohën përkatëse, sipas ligjeve tatimore shqiptare në vendin e origjinës (Arabia Saudite), në Shqipëri ose një kombinim i të dy vendeve – duke ruajtur dokumentacionin origjinal ose duke marrë verifikime të kohëve të fundit për pagesa të mëparshme të tatimeve. Për çdo rast, i takonte kërkueses të argumentonte, në përputhje me Ligjin e Rivlerësimit, se kishte qenë objektivisht e pamundur t'i merrte këto prova, për shembull, sepse të dhënat zyrtare ishin shkatërruar ndërkohë. KPA-ja nuk ishte bindur se kërkuësja e kishte përmbushur këtë barrë, dhe Gjykata nuk konstaton asnjë arsye për ta diskutuar këtë konstatim vendës.

132. Më tej ajo vijon se kjo pjesë e kërkesës duhet të kundërshtohet në të njëjtën mënyrë si qartazi e pambështetur në fakte, sipas nenit 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

IV. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 13 TË KONVENTËS

133. Kërkuësja u ankua se ajo nuk kishte pasur një mjet efektiv në dispozicion për ankesat e saj në mbështetje të nenit 6 § 1 dhe nenit 8 të Konventës. Ajo u mbështet në nenin 13 të Konventës, i cili parashikon, si më poshtë:

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

134. Qeveria shprehu qëndrimin se kërkuësja kishte pasur një mjet efektiv për qëllime të nenit 13 për të ngritur ankesat e saj në mbështetje të neneve 6 dhe 8. Ajo kishte mundur t'i parashtronte këto ankesa fillimisht përpara KPK-së dhe më pas, përpara KPA-së.

135. Kërkuesja argumentoi se ajo nuk kishte pasur një mjet efektiv për të kundërshtuar shkeljen e të drejtave të saj themelore në procesin e rivlerësimit, sipas interpretimit të nenit 13, lexuar së bashku me nenet 6 dhe 8 të Konventës, sepse ajo nuk mund të kundërshtonte shkarkimin e saj përpara gjykatave vendëse apo të paraqiste një ankesë kushtetuese ndaj vendimit të KPA-së.

136. Edhe nëse prezumohet se kërkuesja kishte një “pretendim të argumentueshëm” për qëllimet e nenit 13 të Konventës, në të gjitha aspektet, Gjykata përsërit se nuk është e nevojshme që “autoriteti” referuar në nenin 13 të jetë një autoritet gjyqësor në të gjitha shkallët në kuptimin e ngushtë (shih *Rotaru kundër Rumanisë* [DHM], nr. 28341/95, § 69, GJEDNJ 2000-V, dhe *Drizga kundër Shqipërisë*, nr. 33771/02, § 116, GJEDNJ 2007-V (ekstrakte)). Për çdo rast, siç edhe u vendos në çështjen *Xboxhaj* (cituat më sipër, § 288), si KPK-ja dhe KPA-ja, një kolegji i posaçëm i Gjykatës Kushtetuese, ish-in “gjykata”, sipas qëllimeve të nenit 6. Kërkuesja ishte në pozitë për të ngritur ankesën e saj, në lidhje me nenet 6 dhe 8 përpara këtyre organeve të rivlerësimit.

137. Më tej ajo vijon se kjo pjesë e kërkesës është qartazi e pambështetur në fakte sipas kuptimit të nenit 35 § 3 (a) të Konventës dhe duhet të kundërshtohet në përputhje me nenin 35 § 4.

V. ZBATIMI I NENEVE 46 DHE 41 TË KONVENTËS

138. Pjesët përkatëse të nenit 46 të Konventës parashikojnë si më poshtë:

“1. Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të respektojnë vendimin e formës së prerë të Gjykatës në çdo çështje ku ato janë palë.

2. Vendimi i formës së prerë i Gjykatës i përcillet Komitetit të Ministrave, i cili mbikëqyr ekzekutimin e tij.

...”

139. Neni 41 i Konventës parashikon si më poshtë:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesëshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërbllim të drejtë palës së dëmtuar.”

A. Tregues për masat e përgjithshme dhe individuale

140. Kërkuesja mendonte, referuar nenit 46 § 1 të Konventës, se Shteti përgjegjës duhej të urdhërohej të korrigjonte papërshtatshmëritë themelore në legjislacionin vendës të rivlerësimit dhe të siguronte rikthimin e saj si prokurore dhe anëtare e KLP-së.

141. Qeveria argumentoi se parashikimet ligjore për rivlerësimin ish-in në përputhje me Konventën. Gjithashtu, ajo parashittoi se duke qenë se kërkuesja nuk kishte përmbushur detyrimet e saj sipas Ligjit të Rivlerësimit, që përbënin edhe arsyet për nisjen e procedurave disiplinore ndaj saj, ajo nuk mund të rikthehej në detyrë.

142. Parimet e përgjithshme në lidhje me detyrimet e Shtetit të paditur sipas nenit 46 të Konventës në kontekstin e ekzekutimit të vendimeve ku Gjykata ka konstatuar shkelje të Konventës, përcaktohen, *inter alia*, në vendimin e Gjykatës në çështjen *Oleksandr Volkov* (cituat më sipër, §§ 193–95, me shumë referenca të tjera). Vendimet e Gjykatës janë kryesisht deklarative në natyrë. Neni 46 përfshin kryesisht detyrimin ligjor për të zgjedhur, nën mbikëqyrjen e Komitetit të Ministrave, masat e përgjithshme dhe/ose, nëse është me vend, individuale, që do të miratohen në urdhrin e tij juridik vendës për t’i dhënë fund shkeljes së konstatuar nga Gjykata dhe për të bërë të gjithë korrigjimin e mundshëm për pasojat në mënyrë të tillë që të rikthehet sa më shumë të jetë e mundur situata që ekzistonte përpara shkeljes (*ibid.*).

143. Gjykata shprehet se ka konstatuar një shkelje të së drejtës së kërkueses për të respektuar jetën e saj private sipas nenit 8 të Konventës për shkarkimin e saj, sepse, në rrethanat specifike të çështjes së saj, shkarkimi nuk ishte proporcional me qëllimet legjitime të ndjekura. Megjithatë, ajo nuk mendon se funksionimi i procesit aktual të rivlerësimit në përgjithësi në Shqipëri, mbështetur në Kushtetutë dhe në Ligjin e Rivlerësimit, paraqet problematika sistematike në respektimin e kërkesave

të Konventës (shih tashmë *Xboxhaj*, cituar më sipër, §§ 230 e në vijim). Për këtë arsye, Gjykata nuk e vlerëson si të nevojshme që ajo të përcaktojë në mënyrë përjashtimore ndonjë masë të përgjithshme që mund të ndërmerret për t'i dhënë fund shkeljes në fjalë (krahaso, *a contrario*, *Oleksandr Volkov*, cituar më sipër, §§ 199–202).

144. Për sa ka të bëjë me masat individuale që do të ishin më të përshtatshme për t'i dhënë fund shkeljes së konstatuar në çështjen konkrete, Gjykata përsërit se, në shumë çështje ku ishte konstatuar se procedurat vendëse shkelnin Konventën, ajo ka gjykuar se forma më e përshtatshme për korrigjimin e shkeljeve të konstatuara mund të ishte rihapja e procedurave vendëse (krahaso, për shembull, *Oleksandr Volkov*, cituar më sipër, §§ 205–206, në lidhje me një shkelje të neneve 6 dhe 8).

145. Duke iu referuar konstatimeve të saj në çështjen *Besnik Cani* (cituar më sipër, § 149), Gjykata konstaton se mund të ketë një rrugë ligjore për kërkuesen që të kërkojë rihapjen e procedurave pas konstatimit nga ana e Gjykatës së një shkeljeje të Konventës. Në këtë mënyrë, duke marrë në konsideratë rrethanat e çështjes konkrete dhe për sa mund të ishte e mundur sipas ligjit vendës, një formë e përshtatshme korrigjimi për shkeljen e të drejtës së kërkueses për respektim të jetës së saj private sipas nenit 8 të Konventës, do të ishte rihapja e procesit, nëse kërkuesja e kërkonte një rihapje të tillë, si edhe rishqyrtimi i çështjes në mënyrë të tillë që është në përputhje me parashikimet e nenit 8 të Konventës, ashtu siç përcaktohet në këtë vendim.

B. Dëmshtëpërblimi

146. Kërkuesja kërkoi, në lidhje me dëmin pasuror, shumat që përkonin me humbjen e pagës së saj si prokurore gjatë periudhës së shkarkimit të saj nga detyra më 28 shkurt 2019 deri në rikthimin e saj, paga e saj mujore bruto në vlerën ALL 281,078 (rreth 2,267 euro (EUR)). Nëse nuk rikthehej në detyrë, ajo kërkoi shumën që përkonte me pagën që do të kishte fituar deri në moshën e pensionit dhe shumën që përkonte me pensionin e saj. Në vijim, ajo kërkoi që kjo shumë duhej të përshtatej me normën e inflacionit duke shtuar interesin dhe tatimet e pagueshme.

147. Në vijim, kërkuesja kërkoi 150,000 euro, plus çdo taksë që mund të ishte e tarifueshme për dëmin jopasuror shkaktuar nga ankthi, humbja e reputacionit dhe e mundësive që i kishte vuajtur si pasojë e shkarkimit të saj të menjëhershëm në kulmin e karrierës së saj ligjore si prokurore.

148. Qeveria parashtroi se kërkuesja nuk mund të pretendonte kompensim për humbjen e pagës pasi shkarkimi i saj nuk ishte në shkelje me Konventën. Në vijim, Qeveria parashtroi se pretendimi i saj për kompensim për dëmin jopasuror ishte i tepruar dhe i paargumentuar.

149. Gjykata vlerëson se kërkuesja filloi të praktikonte ligjin si avokate shumë shpejt pas shkarkimit të saj; megjithatë, kalimi i menjëhershëm në atë linjë të re pune nën ato rrethana duhet të ketë shkaktuar dëm pasuror. Duke bërë një vlerësim të drejtë dhe sipas të gjitha informacioneve në zotërimin e saj, Gjykata vlerëson si të arsyeshme që t'i akordojë kërkueses EUR 13,600 për dëm pasuror, plus çdo taksë që mund të jetë e tarifueshme për kërkuesen për atë shumë. Gjithashtu, ajo vlerëson se kërkuesja duhet të ketë pësuar dëm jopasuror, për të cilin konstatimi i shkeljes së Konventës në vendimin e Gjykatës nuk do të mjaftonte për korrigjim, dhe i akordon asaj EUR 6,000 (gjashhtë mijë euro), plus çdo taksë që mund të jetë e tarifueshme për këtë shumë.

C. Kostot dhe shpenzimet

150. Pasi dorëzoi provat dokumentare, kërkuesja kërkoi edhe EUR 5,155 (duke përfshirë taksat) për kostot dhe shpenzimet e bëra përpara Gjykatës.

151. Qeveria parashtroi se, edhe nëse prezumohet se ka pasur një shkelje të Konventës, kostot dhe shpenzimet e pretenduara nga kërkuesja nuk ishin të nevojshme për kuant, duke pasur parasysh kostot dhe shpenzimet e zakonshme të një avokateje që e praktikon ligjin në Shqipëri.

152. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, një kërkues ka të drejtë të rimbursohet për kostot dhe shpenzimet vetëm për atë që është provuar se këto kosto dhe shpenzime janë bërë aktualisht, kanë qenë të nevojshme dhe janë të arsyeshme për kuant. Në çështjen konkrete, për sa u përket

dokumenteve që zotëron Gjykata si edhe kritereve të mësipërme, Gjykata e konsideron të arsyeshme që t'i akordojë kërkuases EUR 5,000 (duke përfshirë taksat) për procesin përpara Gjykatës.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA

1. *E deklaron*, unanimisht, të pranueshme ankesën për shkarkimin e kërkuases në mbështetje të nenit 8 të Konventës;

2. *E deklaron*, me shumicë, pjesën tjetër të kërkesës të papranueshme;

3. *Gjykon*, unanimisht, se është shkelur neni 8 i Konventës për sa i përket shkarkimit të kërkuases;

4. *Gjykon*, unanimisht,

a) se Shteti përgjegjës duhet t'i paguajë kërkuases, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi bëhet i formë së prerë, në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, shumat e mëposhtme, që duhet të konvertohen në monedhën e Shtetit përgjegjës në normën e zbatueshme në datën e pagesës;

i. EUR 13,600 (trembëdhjetë mijë e gjashtëqind euro), plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuases, në lidhje me dëmin pasuror;

ii. EUR 6,000 (gjashtë mijë euro), plus çdo taksë që mund të tarifohet, për dëmin jopasuror;

iii. EUR 5,000 (pesë mijë euro) për kostot dhe shpenzimet;

b) se nga përfundimi i periudhës së sipërpërmendur tremujore deri në pagesë, interesi i thjeshtë duhet të paguhet për shumat e mësipërme në një normë të barabartë me normën marginale huadhënëse të Bankës Qendrore Evropiane plus tre pikë përqindje;

5. *Rrëzohet*, unanimisht, pjesën tjetër të kërkesës së kërkuases për shpërblim të drejtë.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 13 dhjetor 2022, sipas Rregullit 77 § 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Pere Pastor Vilanova
KRYETAR

Milan Blaško
SEKRETAR

Në përputhje me nenin 45 § 2 të Konventës dhe Rregullit 74 § 2 të Rregullores së Gjykatës, opinionioni i veçantë i Gjyqtarit Serghides i aneksohet këtij vendimi.

P.P.V.
M.B.

OPINIONI PJESËRISHT MOSPAJTUES I GJYQTARIT SERGHIDES

1. Unë jam dakord me paragrafin 1 të masave operative të vendimit ku gjykohet se ankesa – sipas nenit 8 të Konventës, për sa ka të bëjë me shkarkimin nga detyra të kërkuases si prokurore – është e pranueshme; dhe, gjithashtu, unë jam dakord me paragrafin 3 të masave operative se me shkarkimin e kërkuases është shkelur neni 8 i Konventës. Gjithashtu, unë jam dakord me paragrafin 4 të masave operative, në lidhje me akordimet për dëmin pasuror dhe jopasuror dhe kostot dhe shpenzimet, dhe me paragrafin 5 të masave operative në lidhje me rrëzimin e pjesës tjetër të kërkesës së kërkuases për shpërblim të drejtë.

2. Megjithatë, nuk jam dakord me paragrafin 2 të masave operative të vendimit sipas së cilit pjesa tjetër e kërkesës është e papranueshme. Veçanërisht, unë jam i mendimit se ankesa sipas nenit 6 të Konventës jo vetëm që është e pranueshme, por madje ky nen është shkelur pasi procesi i rivlerësimit i cili rezultoi në largimin e kërkueses nga pozicioni i saj si prokurore nuk ishte i drejtë sipas kuptimit të nenit 6 § 1.

3. Ky opinion merr formën e një deklaratë mosdakordësie me vendimin (“një deklaratë e drejtpërdrejtë mospajtimi”), në lidhje me paragrafin 2 të masave të tij operative (në lidhje me ankesën sipas nenit 6 të Konventës), dhe për këtë arsye, nuk merr formën e një opinion të veçantë të plotë apo formën e një vote të thjeshtë anonime kundër këtyre paragrafëve. Një deklaratë e thjeshtë mosdakordësie me vendimin ose me një pjesë të tij është një zgjedhje alternativ e parashikuar nga Rregulli 74 § 2 i Rregullores së Gjykatës për gjyqtarët të cilët dëshirojnë të shprehin mospajtim. Kjo zgjedhje është veçanërisht e përshtatshme për mua për t’u bërë për çështjen konkrete, pasi unë kam shprehur mendimet e mia për dy kërkesa të ngjashme ose relevante kundër Shqipërisë (shih, *mutatis mutandis*, qasjen time në opinionin tim mospajtues në vendimin *Xboxhaj kundër Shqipërisë*, nr. 15227/19, 9 shkurt 2021, dhe opinionin tim pjesërisht pajtues dhe pjesërisht mospajtues në vendimin *Besnik Cani kundër Shqipërisë*, nr. 37474/20, 4 tetor 2022 (i cili nuk është ende i formës së prerë)).